



Albanais
Albanisch
Shqip

ETAT DE FRIBOURG
STAAT FREIBURG

Bureau de l'intégration des migrant-e-s
et de la prévention du racisme IMR
Fachstelle für die Integration der MigrantInnen
und für Rassismusprävention IMR

Zyra për integrimin e migrantëve-eve
dhe parandalimin e racizmit

Kantoni i Fribourg-ut ju dëshiron mirëseardhje



2014-2017

Botim 2014

Broshura në versione të ndryshme
gjuhësore mund të shkarkohet nga
www.fr.ch/imr/brochure

Botuesi

Zyra për integrimin e migrantëve-eve
dhe parandalimin e racizmit
Drejtoria për siguri dhe drejtësi,
Grand-Rue 26, 1700 Fribourg

Grafika dhe ilustrimi

Agence Symbol, 1763 Granges-Paccot

Foto e kopertinës

Union Fribourgeoise du Tourisme,
1701 Fribourg
www.fribourgregion.ch

Harta në mesin e broshurës është marrë nga

Office fédéral de la topographie, Berne,
Office fédéral de la statistique: GEOSTAT,
Neuchâtel / Service de la statistique
du canton de Fribourg

Përmbledhje

1. Parathënie	6
2. Si ta përdorim këtë broshurë	7
3. «Bashkëjetesa» në Fribourg	8
Kantoni, distriktet (rrethet), komunat	
Gjuhët zyrtare	
Popullata e huaj	
Integrimi i personave migrantë	
4. Ardha në kanton	10
Lajmëroni ardhjen tuaj	
Informohuni te komuna	
Informohuni duke u konsultuar nga mediat	
5. Të drejtat dhe detyrat	11
Vlerat themelore	
6. Komunikimi	12
Mësimi i frëngjishtes ose gjermanishtes	
Kursët verore për fëmijët shqipfolës	
Kursët e gjuhëve për të rinjë	
Mësimi i leximit dhe shkrimit	
Mësimi i një dialekti zvicerano-gjerman	
Kursët e integrimit	
Përkthyesit nga komunitetet	
Biblioteka ndërkulturore	
7. Banimi	14
Gjetja e banesës	
Taksat për radio dhe televizion (Billag)	
Jeta në ndërtesë me qira	
8. Transportet	16
Veturat	
Importi i automjetëve private	
Ndërrimi i patentë shoferit	
Drejtimi i automjetit në Zvicër	
Transporti publik	
Lëvizja e ngadalshme: biçikletat dhe këmbësorët	

9. Puna	18
Gjetja e punës	
Pagat dhe kontributet sociale	
Ndihmë në menaxhimin e buxhetit	
Sigurimet sociale	
Sigurimi për papunësi	
Ndihma sociale	
Mbrojtja kundër largimit nga puna	
Tatimet	
Tensionet në vendin e punës	
Jo-diskriminimi	
Puna në të zezë	
Personat migrantë pa leje qëndrimi	
10. Shëndeti	22
Sigurimi shëndetësor dhe sigurimi për aksidente	
Mjekët	
Urgjenca	
Kujdesi për dhëmbët	
Urgjenca për dhëmbët	
Personat e moshuar	
Personat me aftësi të kufizuara	
Planifikimi i familjes dhe informatat seksuale	
11. Martesa dhe jeta familjare	26
Martesa	
Partneriteti i regjistruar	
Martesat e detyruara	
Lindja	
Pushimi dhe shtesat e lehonisë	
Shtesat për fëmijë	
Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjëve	
Çiftet dhe familjet në vështirësi	
Dhuna në familje	
12. Harta e kantonit të Friburgut dhe numrat e urgjencës (që shpëputen)	27

13. Edukimi dhe shkollimi i detyrueshëm	34
Përgjegjësia prindërore	
Ruajtja e fëmijëve dhe përkujdesja jashtë-shkollore	
Edukimi parashkollor (nga moshja 4 vjeçare)	
Shkolla fillore (nga moshja 6 vjeçare)	
Cikli orientues-shkolla e mesme (nga moshja 12 vjeçare)	
Orientimi shkollor dhe profesional	
Nxënësit me origjinë të huaj dhe nxënësit shqipfolës	
14. Përgatitja profesionale dhe studimet e specializuara (nga moshja 16 vjeçare)	37
Zanati (mësimi) në ndërmarrje (nga moshja 16 vjeçare)	
Të rinjtë e moshës madhore me origjinë të huaj	
Shkolla e mesme e lartë e shkallës së dytë (nga moshja 16 vjeçare)	
Studimet e larta	
Bursa për studime dhe për arsimim	
Njohja e diplomave dhe çertifikatave	
Shkollimi i të rriturve dhe shkollimi i vazhduar	
15. Mbrojtja e ambientit	40
Pasuritë e një mjedisi të ruajtur	
Mirëmbajtja e peizazhit	
Respektimi i vendeve publike	
Riciklimi i mbeturinave	
Mbeturinat që nuk riciklohen	
16. Jeta shoqërore dhe asociative	42
Festat popullore të Fribourg-ut	
Jeta kulturore dhe sportive	
Ecja këmbë	
Jeta shoqërore	
Jeta fetare	
17. Pjesëmarrja në jetën politike	45
Demokracia direkte	
Organet politike	
Tri nivelet e pushtetit	
Të drejtat politike të personave të huaj	
Format tjera të pjesëmarrjes në politikë	
Natyralizimi	
18. Lista me adresa të nevojshme	48

1. Parathënie

Mirë se vini! Bienvenue! Herzlich willkommen!

Keni zgjedhur të vini dhe të jetoni në kantonin e Fribourg-ut. Autoritetet kantonale dhe komunale, shoqatat e shumta dhe shoqëritë lokale, banoret dhe banorët e Fribourg-ut ju mirëpresin me gëzim!

Keni ardhur në një kanton dinamik, i hapur nga jashtë dhe në të njëjtën kohë i lidhur ngushtë me institucionet dhe traditat e tij. Me peizazhet e tij të larmishme, pluralizmin gjuhësor dhe ekonominë e larmishme, vendi ynë Fribourgu është si një Zvicër në miniaturë. Shpresojmë që ju dhe familja juaj shpejtë do të ndiheni rehat në kantonin e Friburgut. Jeta shoqërore dhe asociative në Friburg është shumë e begatshme. Ju ftojmë që të merrni pjesë dhe t'a zbuloni atë!

Ne jemi krenar për dy-gjuhësinë dhe për mirëkuptimin që mbretëron në mes të përbërësve të ndryshëm të popullatës sonë. Fribourg-u është një kanton që kultivon lidhje të fortë shoqërore. Persona të gjeneratave, origjinave dhe të mendimeve të ndryshme, jetojnë së bashku, në

harmoni dhe respekt të ndryshimeve dhe identiteteve të secilës dhe secilit. Kjo nuk ndodhë vetvetiu, por kërkon përpjekje nga të gjithë. Secili është i thirrur që të praktikojë tolerancë, pluralizëm dhe respekt ndaj minoriteteve, që janë vlera themelore të shtetit dhe shoqërisë sonë.

Në këtë broshurë do të gjeni shumë informata për jetën në kantonin tonë. Gjithashtu ju ftojmë që të takoheni me banorët e Fribourg-ut, ata që jetojnë aty ose me ata që kohëve të fundit kanë ardhur. Përvoja e tyre do t'ju ndihmojë që ta kuptoni më mirë rrethin tuaj të ri, të integroheni aty dhe të ndiheni mirë.

Ne ju dëshirojmë mirëseardhje / Bienvenue / Herzlich willkommen, shumë njoftime e sidomos takime shumë të mira.

Erwin Jutzet
Këshilltar i Shtetit
Conseiller d'Etat
Staatsrat

2. Si ta përdorim këtë broshurë

Me ardhjen tuaj, padyshim do të keni shumë çështje për të rregulluar. Kjo broshurë do t'ju pajisë me informata të përgjithshme. Për të marrë udhëzime më të sakta, duhet të kontaktoni administratën e komunës suaj ose organizatat e shënuara me një shigjetë ►. Këto organizata janë të shënuara me numra sipas radhës së paraqitjes së tyre. Numrat janë të përfshirë në listën e adresave që gjendet në fund të dokumentit. Gjithashtu do të merrni edhe shumë informata duke biseduar me njerëzit që do t'i takoni në lagjen tuaj, fshatin tuaj, në punë ose gjatë kohës së lirë. Në mes të broshurës, do të gjeni një fletë që mund të shkëputet, në të cilën është harta e kantonit të Fribourg-ut, numrat kryesorë të urgjencës si dhe

disa informata të përgjithshme. Një pjesë e madhe e web-faqeve të shënuara në këtë broshurë janë në të dy gjuhët. Udhëzimet për ndërrimin e gjuhës (F/D, f/de, Français/Deutsch, etj.) paraqiten gjithmonë lartë në të djathtë sikur në faqen e Shtetit të Fribourg-ut, www.fr.ch ose në atë të Konfederatës www.admin.ch.

3. «Bashkëjetesa» në Fribourg

Fribourg-u është kanton i larmishëm dhe i qetë ku njerëzit jetojnë së bashku duke respektuar dallimet dhe identitetin e secilës dhe secilit.

Kantoni, distriktet (rrethet), komunat

Kantoni i Fribourg-ut është njëri nga 26 kantonet e Konfederatës zvicerane. Ai numëron afërsisht 300 000 banorë dhe banore, që banojnë në shtatë distrikte (rrethe) dhe 163 komuna (2014). Kryeqyteti i kantonit është qyteti i Fribourg-ut (37 000 banorë).

Site web du canton de Fribourg – Web-faqja e Kantonit të Fribourg-ut.

www.fr.ch

Gjuhët zyrtare

Fribourg-u është kanton dygjuhësh. Dy gjuhët zyrtare të tij janë frëngjishtja dhe gjermanishtja.

Ndryshe nga Zvicra, frankofonët janë shumicë në kantonin e Fribourg-ut. Ata dhe ato përfaqësojnë afërsisht dy të tretat e popullatës, kundrejt një të tretës gjermanofone që gjendet kryesisht në distriktet (rrethet) e Singine -s, të Lac-ut dhe Sarine-s. Frankofonët flasin fëngjishten «klasike» me një theks të regjionit. Ndonjëherë dëgjohet të flitet dialekti i vjetër patois fribourgois, me origjinë franko-provensale.

Në jetën e përditshme, banorët gjermanofonë të Fribourg-ut flasin në mes vete një dialekt zvicerano-

gjerman, dialektin Singinois (Seislerdütsch) ose dialektin Bernois (Bärndütsch). Në qytetin e vjetër të Fribourg-ut, mund të dëgjohet gjithashtu dialekti Bolze, nga dialekti Singinois i përzier me frëngjisht. Megjithatë, gjermanofolësit e përdorin gjermanishten standarde (Hochdeutsch) me jo-gjermanofolësit në manifestimet zyrtare ose në shkollë, si dhe në komunikimet me shkrim.

Monumenti Röstigraben

Në gjuhën familjare, kufiri imagjinar që ndanë Romandinë frankofone nga Zvicra gjermane është quajtur «barrière de Röst» në frëngjisht, «Röstigraben» në gjermanisht. Röstit janë galeta (lloj pite) nga patatet që konsiderohen si specialitet tipik i Zvicrës gjermane. Në qytetin e vjetër të Fribourg-ut mund ta admirojmë «Monumentin Röstigraben».

Në administratën kantonale mund të flisni frëngjisht ose gjermanisht. Të gjitha dokumentet zyrtare të kantonit janë të shtypura në të dy gjuhët. Në nivelin lokal, sipas komunave, situata është ndryshe. Në fakt, numri i personave që flasin frëngjisht ose gjermanisht mund të ndryshoj nga njëra komunë në tjetrën.

Shqip	Hap ombrellën tënde!
Frëngjisht	Ouvre ton parapluie!
Patois fribourgeois / Freiburger Patois	Àrà ton pyodzè!
Gjermanisht	Öffne deinen Regenschirm!
Seislerfüttsch / Singinois	Tuuf dy Paraplüi!
Bärendütsch / Bernois	Mach dy Rägäschild ufl!
Bolze	Tuuf dy Paraplüi!

Popullata e huaj

Në kantonin e Fribourg-ut jetojnë rreth 60000 persona te nacionaliteteve të huaja, ose afërsisht 20% e popullatës. Një e katërta e tyre janë lindur në kanton e më tepër se 80% vijnë nga Bashkimi europian. Komuniteti portugez paraqet grupin më të madh (afërsisht 1/3 e popullatës së huaj në kanton).

Integrimi i personave migrantë

Me më tepër se 160 nacionalitete, popullata e huaj e kantonit është shumë e larmishme. Në mënyrë që të favorizohet bashkëjetesa dhe shkëmbimi në mes të personave me origjinë të huaj dhe popullatës zvicerane, autoritetet e Fribourg-ut bëjnë politikë aktive për integrim. Ato inkurajojnë veçanërisht migrantët në mësimin e të dy gjuhëve zyrtare të kantonit. Shumë komuna kanë caktuar

persona përgjegjës për çështjet e integritimit.

Integrimi i personave që kanë të bëjnë me azilin dhe refugjatët është në kompetencën e Shërbimit për veprim social. Kjo detyrë është vënë në vepër falë një dispozitivi për integrim specifik. Pranimi, strehimi, inkuadrimi dhe integrimi i personave azilkërkues, të pranuar përkohësisht dhe azilkërkuesve me përgjigje negative janë të siguruar nga shoqëria ORS Service. Inkuadrimi dhe integrimi i personave refugjatë janë në ngarkesë të Caritas Suisse në Fribourg.

- ▶ (1) Zyra për integrimin e migrantëve-eve dhe parandalimin e racizmit
- ▶ (2) Forumi për integrimin e migrantëve dhe migrantëve - FIMM
- ▶ (3) Shërbimi për veprim social

Web-faqja ORS Service

www.ors.ch

Web-faqja Caritas Suisse

www.caritas.ch

Kantoni Fribourg – Qyteti Fribourg

Sikur 15 nga 26 kantonet e Zvicrës edhe kantonin e Fribourg-ut mbanë emrin e kryeqytetit të tij, qyteti i Fribourg-ut. Shkurtesa e kantonit është FR. Këtë do ta hasni kryesisht në tabelat e regjistrimit të veturave.

4. Ardhja në kanton

Administrata e komunës suaj do t'ju pajisë me informata të nevojshme për të lehtësuar vendosjen tuaj në kanton.

Lajmëroni ardhjen tuaj

Nëse dëshironi që të vendoseni në njëren nga komunat e kantonit ose të qëndroni aty më tepër se tre muaj, duhet të lajmëroheni personalisht te administrata komunale brenda 14 ditëve prej ardhjes suaj. Personat me shtetësi zvicerane dhe ata me shtetësi të huaj që kanë qëndruar tanimë në një komunë tjetër të Fribourg-ut duhet të paraqiten personalisht te shërbimi i kontrollit të banorëve të komunës së re të banimit. Ndërsa personat me shtetësi të huaj që vijnë nga jashtë ose nga një kanton tjetër duhet që të shkojnë së pari te Shërbimi kantonal për popullatë dhe migrantë (Service cantonal de la population et des migrants), që gjendet në Granges-Paccot, të pajisur me pasaportën e tyre. Ata pastaj duhet të lajmërohen te shërbimi i kontrollit të banorëve në komunën e vendbanimit të tyre (Frëngjisht: Contrôle des habitants / Gjermanisht: Einwohnerkontrolle).

Lista e komunave të Fribourg-ut

Frëngjisht: www.fr.ch > Etat et droit >

Communes > Annuaire des communes

Gjermanisht: www.fr.ch > Deutsch > Staat

und Recht: > Gemeinden > Datenbank der Gemeinden

► (4) Shërbimi për popullatë dhe migrantë

Informohuni te komuna

Gjatë vizitës në administratën komunale, ju këshillojmë që të informoheni edhe për jetën në komunë dhe aktivitetet shoqërore, sportive e kulturore që zhvillohen aty. Pjesëmarrja në këto aktivitete është mundësi e shkëlqyeshme për integrim. Shpeshherë mund të gjeni informata edhe në tabelat për afishim te administrata e komunës suaj. Shumica nga komunat japin informacione të shumta në faqet e tyre të internetit.

Informohuni duke konsultuar mediat

Në internet dhe në media, do të gjeni një mori informatash për kantonin e Fribourg-ut. Gazetat lokale do t'ju mësojnë shumë për jetën në regjionin tuaj. Aty do të gjeni oferta pune dhe banimi, data manifestimesh, adresa si dhe këshilla të dobishme për jetën e përditshme.

► (5) Gazetat kryesore të Fribourg-ut

► (6) Radiot regjionale

► (7) Televizioni regjional

5. Të drejtat dhe detyrat

Sipas nenit të parë të Kushtetutës kantonale të 16 majit 2004, kantoni i Fribourg-ut është shtet i së drejtës së lirë, demokratik e social.

Vlerat themelore

- Shteti ka qëllim kryesor promovimin e së mirës së përbashkët dhe ndihmën në zhvillimin individual. Në këtë rast ai garanton respektin e së drejtës. Shteti mund të veproj vetëm nëse e autorizon Kushtetuta ose ligji. Ai është i organizuar sipas parimit të ndarjes së pushteteve. Drejtësia, në veçanti, është e pavarur nga qeveria.
- Populli është sovran. Ai ushtron pushtetin e tij direkt, duke u prononcuar për Kushtetutën dhe ligjet, e në mënyrë indirekte përmes autoriteteve që ai i zgjedhë. Në kantonin e Fribourg-ut, populli zgjedhë qeverinë (Conseil d'État), parlamentin (Grand Conseil), prefektët dhe prefektet. Ai poashtu zgjedhë edhe autoritetet komunale si dhe përfaqësuesit-et në Parlamentin federal (Këshilli nacional dhe Këshilli i Shteteve).
- Nga njëra anë, çdo person që jeton në kanton duhet t'i përmbush detyrimet që i parashtohen nga Kushtetuta dhe ligjet: pagesa e taksave, shkollimi i fëmijëve, etj. Në anën tjetër ai gëzon të drejtat themelore siç është e drejta në integritetin fizik, në barazi (sidomos para drejtësisë), në jo diskriminim (veçanërisht për arsye gjinore dhe

kombësie), në martesë ose edhe në lirinë e të shprehurit, të besimit dhe të menduarit.

- Të drejtat themelore nuk janë absolute. Shteti mund t'i kufizojë ato për të garantuar sigurinë, rendin ose shëndetin e bashkësisë. Liritë e çdo individit ndalen aty ku fillojnë liritë e tjetrit. Për shembull, nuk mund të kërkojmë liri të besimit e të refuzojmë ligjet shkollore. Kështu pra, liria e të shprehurit, për shembull, nuk autorizon të ofenduarit e një personi apo të një grupi personash.

«Liria është mundësi që të bësh të gjitha ato që nuk e dëmtojnë tjetrin: kështu ushtrimi i të drejtave natyrore të secilit ka kufijë nëse sigurohet gëzimi i të drejtave të njëjta, për anëtarët tjerë të Shoqërisë». *Deklarata e të drejtave të njeriut dhe qytetarit e vitit 1789, neni 4.*

Kushtetuta e kantonit të Fribourg-ut (Constitution du canton de Fribourg)

Frëngjisht: www.fr.ch > Etat et droit > Constitution > Constitution du 16 mai 2004
Gjermanisht: www.fr.ch > Deutsch > Staat und Recht > Verfassung > Verfassung vom 16. Mai 2004

Ligjet kantonale (Lois cantonales)

Frëngjisht: www.fr.ch > Etat et droit >

Législation > Législation fribourgeoise

Gjermanisht: www.fr.ch > Deutsch > Staat und Recht > Gesetzgebung > Freiburgische Gesetzgebung

Kushtetuta federale (Constitution fédérale)

Frëngjisht: www.admin.ch > Français > Accès direct > Constitution fédérale

Gjermanisht: www.admin.ch > Direkt zu > Bundesverfassung

Ligjet federale (Lois fédérales)

www.admin.ch > Français > Accès direct > Recueil systématique

Gjermanisht: www.admin.ch > Direkt zu > Systematische Rechtssammlung

6. Komunikimi

Komunikimi, është të kuptosh dhe të kuptohesh nga të tjerët.

Mësimi i frëngjishtes ose gjermanishtes

Të folurit e njëres nga dy gjuhët zyrtare të kantonit, frëngjishtes apo gjermanishtes, lehtëson shumë procesin e integritimit. Për më tepër, për personat që jetojnë në një komunë gjermanofone, është një përparësi e madhe që të kuptojnë edhe dialektin e Zvicrës gjermane.

Shoqatat e shumta, komunat dhe shkollat, organizojnë kurse të frëngjishtes dhe të gjermanishtes për personat që kanë ardhur rishtas në kantonin e Fribourg-ut. Pjesa më e madhe e këtyre organizimeve është e përfshirë në një grup informacioni të quajtur COLAMIF, koordinimin e të cilin e ka marrë përsipër Kryqji i Kuq i Fribourg-ut.

- ▶ (1) Zyra për integrimin e migrantëve-eve dhe parandalimin e racizmit
- ▶ (8) Koordinimi kantonal kurse gjuhe për migrantë - COLAMIF

Lista e kurseve të frëngjishtes dhe gjermanishtes

Frëngjisht: www.fr.ch/imr/cours

Gjermanisht: www.fr.ch/imr/kurse

Kurset verore për fëmijët shqipfolës

Kurset verore për nxënësit shqipfolës që propozohen çdo vit.

- ▶ (9) a) Pjesa frankofone: Shërbimi i arsimimit të obligueshëm i gjuhës frënge
www.fr.ch/senof > Migration et intégration > Cours d'été pour enfants allophones
- b) Pjesa gjermanofone: Shërbimi i arsimimit të obligueshëm i gjuhës gjermane
www.doa.ch > Migration und Integration > Sommerkurse

Kurset e gjuhëve për të rinjë

Për kurset që iu dedikohen veçanërisht një publiku të ri, ju lutemi të kontaktoni Sherbimin e shkollimit profesional

► (10) Shërbimi për përgatitje profesionale

Mësimi i leximit dhe shkrimit

Disa persona kanë vështirësi për të lexuar ose për të shkruar një tekst. Shoqata Lire et Ecrire (Lexim dhe Shkrim) organizon kurse për të rritur që janë pak të kualifikuar, që flasin frëngjishten ose gjermanishten por që kanë nevojë t'i përmirësojnë aftësitë e tyre në lexim dhe shkrim.

► (11) Shoqata Lexim dhe Shkrim – Dega në Fribourg

Mësimi i një dialekti zvicerano-gjerman

Gjuhët e folura, dialektet në përgjithësi, mësohen duke biseduar me persona tjerë. Zotërimi i një dialekti mund të jetë shumë i nevojshëm, sidomos në planin profesional. Ekzistojnë edhe kurse për dialekt. Dhomat e tregtisë së Zvicrës Romane (Les Chambres de Commerce de Suisse Romande) lëshojnë diploma për dialektin e Zvicrës gjermane (Schwyzerdütsch).

Dhoma e tregtisë dhe industrisë në Fribourg

Frëngjisht: www.cfcis.ch > Prestations > Conférences et formations > Diplôme de Schwyzertütsch
Gjermanisht: www.cfcis.ch > Deutsch > Dienstleistungen > Konferenz und Ausbildung > Schwyzertütsch Diplom

Kurset e integritimit

Nëse e kuptoni frëngjishten ose gjermanishten dhe dëshironi të thëlloni njohuritë tuaja mbi jetën në Zvicër, e keni mundësinë të ndiqni kursin e integritimit «Jeta në Zvicër» i organizuar nga Kryqi i kuq i Friburgut.

► (12) Kryqi i kuq i Friburgut: Kursi «Jeta në Zvicër»

Përkthyesit nga komunitetet

Në disa situata kur personat migrantë nuk e kuptojnë frëngjishten ose gjermanishten mund të kërkojnë ndihmë nga përkthyesit e komuniteteve. Këta përkthyes janë të përgatitur për të ndihmuar në kuptimin e dyanshëm, për të evituar keqkuptimet dhe ndihmuar personat migrantë që të adaptohen në mjedisin e ri.

► (13) Caritas Zvicër Dega e Friburgut, Shërbimi i interpretuesëve (përkthyesëve) ndërkulturor «se comprendre»

Këshillohet që asnjëherë të mos shfrytëzohen fëmijët si përkthyes.

Biblioteka ndërkulturore

LivreEchange është bibliotekë që ofron mundësi për huazimin e librave në më shumë se 200 gjuhë si dhe metoda të mësimin të frëngjishtes dhe të gjermanishtes.

► (14) Biblioteka ndërkulturore LivreEchange

7. Banimi

Pjesa më e madhe e popullatës së kantonit të Fribourg-ut jeton në ndërtesa me qira.

Gjetja e banesës

Banesa me qira do të gjeni

- duke shikuar ofertat në gazeta
- duke kontaktuar drejtpërdrejtë me agjenci imobiliere
- duke konsultuar faqet e specializuara të internetit.

Disa komuna kanë lista me banesa të zbrazëta. Në lidhje me këtë mund të informoheni nga administrata e komunës suaj. Gjithashtu mund të kontaktoni edhe ata që i njihni, të cilët ndoshta do të kenë ndëguar për ndonjë banesë me qira dhe ndoshta do të mund t'ju ndihmojnë në kërkimet tuaja.

Kërkim banese në Internet

Frëngjisht: www.cfi-ikf.ch > A louer
Gjermanisht: www.cfi-ikf.ch > Deutsch > Zu vermieten
www.laliberte.ch > Immo
www.immoscout24.ch
www.immobref.ch
www.immostreet.ch
www.homegate.ch

Kërkim agjencie imobiliere (banesore) në kantonin e Fribourg-ut

www.les-agences-immobilieres.ch

Për të marrë një kontratë qiraje, duhet plotësuar formularin e regjistrimit

te agjencia imobiliere dhe duhet dorëzuar disa dokumente siç janë për shembull, çertifikata e rrogës, vërtetimi nga Zyrat për borxhlinjë (frëngjisht «Office des poursuites»/gjermanisht «Betreibungsamt»), ose vërtetimi i vendbanimit. Është e këshillueshme që këto dokumente të përgatiten më herët në mënyrë që të mund të vepronin më shpejtë në rast se ju intereson banesa e zbrazët.

Web faqet e Zyrave të borxheve dhe Zyrës së falimentimeve

Frëngjisht: www.fr.ch/opf > Comment obtenir > Une attestation des Offices de poursuites
Gjermanisht: www.fr.ch/BKa > Wo erhalte ich was > eine Bescheinigung des Betreibungsamtes

Pagesa e një garance të qirasë

Për lidhjen e një kontratë qiraje është e domosdoshme një garancë financiare. Shuma e saj është sa tre herë qiraja mujore e banesës. Individët të cilët nuk kanë shumën e kërkuar mund t'i drejtohen një shoqërie të specializuar.

Qiraja e subvencionuar

Në parim, agjensitë qiradhënëse informojnë kur një banesë është e subvencionuar. Për informata plotësuese është në dispozicion Shërbimi i banimit.

► (15) Shërbimi për strehim

Në rast kontesti në mes pronarit dhe qiraxhiut, mund t'i drejtoheni:

- (16) Shoqata zvicerane e qiraxhinjëve – Dega në Fribourg
- (17) Shoqata e qiraxhinjëve gjermanofonë të Fribourg-ut

Taksat për radio dhe televizion (Billag)

Çdo amvisëri e cila disponon me një pajisje me të cilën është e mundshme dëgjimi i radios dhe shiqimi i televizionit duhet t'i paguaj taksë shoqërisë Billag, me vërejtje se mund të merr një dënim në rast mospagese. Personat të cilët marrin shpërblime plotësuese federale lirohen nga kjo taksë nëse për këtë parashtrojnë kërkesë me shkrim.

Frëngjisht: www.billag.ch > Accès rapide > Réception à titre privé > Inscription
Gjermanisht: www.billag.ch > Schnellzugriff > Privater Empfang > Anmeldung

Vend qiraxhinjësh


Në Zvicër, dy të tretat e familjeve janë qiraxhinjë. Vetëm një e treta e popullatës janë pronarë të shtëpive të tyre.

Jeta në ndërtesë me qira

Jeta në ndërtesë me qira nënkupton respektim rregullash për fqinjësi të mirë. Duhet, për shembull, të evitoni zhurmën gjatë natës (zakonisht nga ora 22 deri në orën 7 të mëngjesit), të dielave, si dhe ditëve festive.

Rregullat kryesore për bashkëjetesë janë të përfshira në kushtet e përgjithshme për banim nga Dhoma e Fribourg-ut për patundëshmëri (Chambre fribourgeoise de l'immobilier), ndërsa rregullat më specifike për shfrytëzimin e zonave të përbashkëta, siç është lavanderia, përfshihen në rregulloren e ndërtesës, e cila dorëzohet së bashku me kontratën e banesës.

Po patët vështirësi me qiraxhinjët tjerë, kërkonte dialog, është zgjidhja më e mirë. Në rast nevojë, mund të flisni edhe me kujdestarin ose në regji (administrata banesore).



8. Transportet

Në kantonin e Fribourg-ut, sikurse në pjesët tjera të Zvicrës, më shumë se çdo i dyti person ka veturë. Edhe rrjeti i transportit publik është shumë i dendur.

Veturat

Në Zvicër, nuk ka taksa autostrade. Megjithatë, duhet blerë vinjeta (ngjitet brenda veturës në xhamin e përparmë) që të mund të qarkulloni nëpër autostradat e vendit. Në shumë pika të blerjes (pika doganore, garazha, zyra poste, etj.) ofrohen vinjeta prej 40 frangash (çmimi 2014).

Importi i automjeteve private

Nëse jeni në Zvicër dhe keni veturë prej së paku 6 muaj, duhet të paguani taksë për importin e saj në Zvicër. Kur një automjet i regjistruar jashtë vendit parkohet në Zvicër për më gjatë se një vit, dhe atë pa ndërprerje për tre muaj rresht, është e domosdoshme marrja e lejes për qarkullim dhe targave të kontrollit zviceran.

Ndërrimi i patentë shoferit

Të huajtë që kanë patentë shoferi e që vendosen në Zvicër kanë afatin prej 12 muajsh për të ndërruar patentën me një patentë shoferi të Zvicrës (me format të një kartë-kredie). Kushtet që duhet plotësuar ndryshojnë sipas vendit të prejardhjes.

Zyra për qarkullim dhe lundrim do t'iu informojë për hapat që duhet t'i

merrni dhe dokumentet e duhura për dorëzimin e kërkesës për regjistrim ose ndërrim patente, si dhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me automjetet motorike.

► **(18) Zyra për qarkullim dhe lundrim e kantonit të Fribourg-ut**

Kërkim hartash dhe itinerarësh

www.mapsearch.ch

Drejtimi i automjetit në Zvicër

Drejtuueset dhe drejtuesit zviceranë të automjeteve, në përgjithësi, janë të kujdesshëm dhe të disiplinuar. Në vend janë në fuqi kufizimet e shpejtësisë siç vijojnë: 50 km/h në lokalitete, 80 km/h jashtë lokaliteteve, 120 km/h nëpër autostrada. Nëpër lokalitete, mund të ketë zona ku shpejtësia është e kufizuar në 30 km/h, ose edhe 20 km/h. Norma maksimale e lejuar e alkoolit është 0,5 ‰. Ndalesa e konsumimit të alkoolit iu shqiptohet disa kategorive të drejtuesëve të automjeteve (p.sh. shoferët profesionistë dhe drejtuesit me leje të përkohshme ose provuese). Çdo drejtuese dhe drejtuesi automjeti ka obligim që të ndalet para kalimit për këmbësorë në rast se është dikush që dëshiron të kalojë rrugën. Duhet të jemi shumë vigjilent në afërsi të

shkollave. Nëse automjeti është i ndalur, për shembull, kur është e ndezur drifia e kuqe në semafor, në parim, duhet fikur motori.

► **(18) Zyra për qarkullim dhe lundrim e kantonit të Fribourg-ut**

Transporti publik

Zvicra ka një rrjet të transportit publik të dendur dhe efikas. Biletat e trenit, autobusit ose anijes janë relativisht të shtrenjëta, por me blerjen e një abonimi gjysëm-tarifor në kompaninë hekurudhore kombëtare CFF/SBB (175 franga në vit, çmimi 2014) mund të paguani vetëm gjysmën e çmimit të biletës. Ky abonim është shumë i kërkuar: e ka gati çdo i dyti banorë. Udhëtimi me fëmijët është më i lirë. Fëmijët nga moshë 6 deri 16 vjeçare që shoqërohen nga njëri prind, udhëtojnë falas me kartën junior (çmimi 2014: 30 franga në vit). Ka edhe shumë zbritje tjera, sidomos për të rinjët («Voie 7») dhe për personat e moshuar. Që çmimi me zbritje t'iu pranohet gjatë inspektimit të biletave, duhet që gjithmonë të keni me vete një dokument identiteti, në mënyrë që të vërtetohet moshë juaj.

Frëngjisht: www.cff.ch > Abonnements et billets

Gjermanisht: www.sbb.ch > Abos & Billette

Disa nga komunat vënë në dispozicion karta difore të transportit publik me çmime të volitshme. Informohuni te komuna juaj!

Kampion botëror

Zviceranët dhe Zviceranet janë kampion botëror për udhëtime me tren me mesatarisht 2422 kilometra të kaluara në vit.

Nëse doni të shfrytëzoni transportin publik vetëm në kantonin e Fribourg-ut por jo në pjesët tjera të Zvicrës, mund të bleni biletë ose abonim FriMobil, vlefshmëria e të cilit është e kufizuar për disa zona ose për tërë territorin e kantonit.

www.frimobil.ch

Transportet publike të Fribourg-ut

www.tpf.ch

Lëvizja e ngadalshme: biçikletat dhe këmbësorët

Në Zvicër, shumë persona lëvizin me biçikleta dhe këmbë për të shkuar në punë, në shkollë ose në kohë të lirë. Këto janë mënyra jo-ndotëse të transportit, pak të kushtueshme dhe të dobishme për shëndetin. Për çiklistët propozohen Itinerare të ndryshme nga kantoni. Ju lutemi kontrolloni me sigurimin tuaj a jeni të mbrojtur ju dhe fëmijët tuaj në rast aksidenti (sigurimi përgjegjësi civile dhe sigurimi në rast aksidenti: Frëngjisht: assurance responsabilité civile dhe assurance accidents / Gjermanisht: Privathaftpflichtversicherung dhe Unfallversicherung).

Lëvizja me biçikletë

Frëngjisht: www.fribourgregion.ch > Activités

> Vélo, VTT, Roller

Gjermanisht: www.fribourgregion.ch > D >

Aktivitäten > Velo, Bike, Inline

www.pro-velo-fr.ch

Frëngjisht: www.ch.ch > FR > A-Z > Vélo -

rouler en Suisse

Gjermanisht: www.ch.ch > A-Z > Velofahren

in der Schweiz

www.publibike.ch

www.veloland.ch

Kërkim hartash dhe itinerarësh

www.mapsearch.ch

9. Puna

Të punosh do të thotë të plotësosh nevojat tua si dhe të familjes, të ndihmosh integrimin tënd, integrimin në shoqërinë e Fribourg-ut dhe të takosh persona tjerë.

Gjetja e punës

Për të gjetur punë, më së miri është të kombinosh shumë hapa (mundësi):

- përgjigje në ofertat e punës të shpallura në gazeta
- kërkimet në Internet
- dërgimi i kandidaturave spontane në ndërmarrje
- kontakti me agjenci të punësimit
- kontakti me të njohurit tuaj
- regjistrimi te zyra regjionale për punësim (ORP / RAV)

Kërkim pune

Frëngjisht: www.fr.ch/spe > Chômage >

Trouver un emploi

Gjermanisht: www.fr.ch/ama >

Arbeitslosigkeit > Eine Stelle finden

www.espace-emploi.ch

www.travailler-en-suisse.ch

Paga dhe kontributet sociale

Në Zvicër, pagat bruto janë relativisht të larta, por edhe jetesa është e shtrenjtë. Nuk ka paga minimale, kjo vlenë për të gjithë sektorët. Megjithatë, në shumë degë ka paga minimale konvencionale.

Kontributet e obligueshme zbriten nga paga për sigurimin e pleqërisë dhe të mbijetuarve (AVS), sigurimin invalidor (AI), sigurimin për papunësi (assurance-chômage), etj. Në qoftë se fitoni më shumë se 21 060 franga në vit (2014), do t'ju zbriten kontribute edhe për kujdes profesional (prévoyance professionnelle) (e ashtuquajtur shtylla e dytë-deuxième pilier), që kompletton AVS-in (që është shtylla e parë-premier pilier). Shtylla e tretë (troisième pilier) përbëhet nga kursimet private. Shuma e përgjithshme e kontributeve shkon përafërsisht në 15% të të ardhurave. Edhe sigurimi shëndetësor është i obligueshëm, por kontributi

për këtë sigurim nuk zbritet nga paga, duhet paguar ju vet me anë të fakturës (shih kapitullin 10 për shëndetësinë).

Ndihmë në menaxhimin e buxhetit

Frëngjisht: Fédération romande des consommateurs: www.frc.ch > Utile au quotidien > Les activités budget de la FRC > Budget-conseil Fribourg

Frëngjisht dhe Gjermanisht: Caritas Fribourg: www.caritas-fribourg.ch > Prestations > Aide à la gestion de budget

Impuls District du Lac / Impuls Seebezirk:

www.impulsmurten.ch

Gjermanisht: Budget-Beratungsstelle

Sensebezirk: www.tafers.ch > Gesundheit, Soziales > Soziale Dienste > Budgetberatung Sensebezirk

Sigurimet sociale

Sigurimi kryesor social është Sigurimi i pleqërisë dhe të mbijetuarve AVS (Assurance –vieillesse et survivants). Në parim, të gjithë personat fizikë që banojnë në Zvicër janë të regjistruar te AVS, qofshin ata me shtetësi zvicerane apo të huaj, me apo pa aktivitet fitimprurës. Në rast mosaktiviteti fitimprurës verifikoni parapagimet tuaja në AVS. Mosha e caktuar e pensionimit është mosha 65 vjeçare për burrat, ndërsa 64 vjeçare për gratë (2014). Është e mundur që të shkohet në pension të parakohshëm, por me zvogëlim pensioni. Kontributet sociale të paguara më parë jashtë vendit, në përgjithësi, merren parasysh në Zvicër për llogaritjen e përfitimeve. Informohuni te Arka për kompensim e kantonit të Fribourg-ut (Caisse de compensation du canton de Fribourg).

Kontributet për sigurimin invalidor (AI) zbriten me ato të AVS. Në rast invaliditeti, sigurimi jep të drejtën për përkrahje për riintegrim në tregun e punës ose për pension. Ndërsa, shtesat për fëmijë dhe ato të lindjes janë të financuara ndryshe.

► (19) Arka për kompensim e kantonit të Fribourg-ut

Sigurimi për papunësi

Nëse një person në Zvicër e humb punën, ai normalisht merr kompensim për papunësi gjatë një periudhe. Në parim, një person që vie nga jashtë për herë të parë në Zvicër nuk përfiton nga sigurimi për papunësi: ai e ka këtë të drejtë vetëm nëse ka leje qëndrimi dhe ka punuar në Zvicër së paku 12 muaj gjatë dy viteve që i kanë paraprirë regjistrimit të tij në entin për papunësi. Në kushte të caktuara, periudhat e sigurimit dhe të punësimit jashtë vendit, merren parasysh për pjesën më të madhe të shtetasëve të vendeve europiane. Për këtë do të mund t'ju informojnë arkat për papunësi (caisses de chômage).

► (20) Shërbimi publik për punësim

Listat e arkave për papunësi

Frëngjisht: www.fr.ch/spe > Chômage > Inscription > Liste des caisses

Gjermanisht: www.fr.ch/ama >

Arbeitslosigkeit > Anmeldung > Liste der Arbeitslosenkassen

Personat që humbin punën duhet të lajmërohen sa më shpejtë. Nëse ata janë me banim në komunat e Friburgut,

Tavelit ose Villars-sur-Glâne, duhet të lajmërohen te administrata komunale. Personat që jetojnë në komunat tjera duhet t'i drejtohen Zyrës regjionale të punësimit (Frëngjisht: ORP / Gjermanisht: RAV) të qarkut përkatës. Komuna gegjësisht ORP do të ju informon për hapat që duhet ti ndërmerrni për realizimin e shpërblimeve nga Enti i të papunëve.

Regjistrimi në entin për papunësi

Frëngjisht: www.fr.ch/spe > Chômage > Inscription

Gjermanisht: www.fr.ch/ama > Arbeitslosigkeit > Anmeldung

Lista e Zyrave regjionale të punësimit

Frëngjisht: www.fr.ch/spe > Chômage > Comment s'inscrire > Autre commune > Liens internes > Les ORP du canton de Fribourg

Gjermanisht: www.fr.ch/ama > Arbeitslosigkeit > Anmeldung > Andere Gemeinde > Link intern > Die RAV des Kantons

Ndihma sociale

Ndihma sociale ka për qëllim të sigurojë minimumin jetësor dhe të promovojë pavarësinë ekonomike dhe personale të individëve në nevojë. Ajo jipet atëherë kur personi nuk mund të mbahet nga familja e tij ose nuk mund të marrë nga përfitimet tjera ligjore për të cilat ai ka të drejtë. Megjithatë, ndihma sociale nuk është një e drejtë. Ajo duhet të kthehet në momentin kur personi përmirëson gjendjen financiare.

► (3) Shërbimi për veprim social

Për të kërkuar ndihmë sociale, duhet t'i drejtoheni shërbimit social regjional me të cilin është e lidhur komuna ose vendqëndrimi juaj.

Frëngjisht: www.fr.ch/sasoc > Aide sociale > Télécharger > Liste des centres sociaux régionaux

Gjermanisht: www.fr.ch/ksa > Soziale Hilfe > Download > Liste der regionalen Sozialdienste des Kantons Freiburg

Mbrojtja kundër largimit nga puna

Ligji mbron punëtorët-et kundër largimit nga puna në rast sëmundje, aksidenti, shtatzënie ose lindje. Largimi nga puna gjatë këtyre periudhave është jo i vlefshëm (jovolid). Megjithatë, në rast të largimit të pa drejtë për arsye tjera, i/e punësuar-i-a nuk do të mund të ri-integrohet më në atë ndërmarrje, por mund të marrë vetëm kompensim nga gjykata.

► (19) Fondi për kompensim i kantonit të Fribourg-ut

Sigurimet sociale në Zvicër (në gjuhë të ndryshme)

Frëngjisht: www.ofas.ch > Thèmes

Gjermanisht: www.bsv.ch > Themen

Tatimet

Në Zvicër, personat privat paguajnë tatime mbi të ardhurat dhe mbi pasurinë. Kështu, shumat e mbledhura shërbejnë për të financuar detyrat publike të kryera nga Konfederata, kantonet dhe komunat.

Pas ardhjes suaj në kanton, do të merrni një pyetësor nga Shërbimi kantonal për kontribute për përcaktimin e shumës provizore të tatimeve tuaja.

Nëse jeni me shtetësi të huaj e që nuk keni leje-qëndrimin (permis C), taksa mbi të ardhurat do të zbritet drejtpërdrejtë nga paga juaj (Frëngjisht: impôt à la source / Gjermanisht: Quellensteuer).

Nëse keni leje-qëndrim, në muajin janar do të merrni një formular për deklarimin e tatimit. Për t'a plotësuar, mund të përdorni softverin falas FRITax. Në rast vështirësie, drejtohuni te Shërbimi për kontribute ose te ndonjë kontabilist.

► (21) Shërbimi kantonal i tatimeve

Softveri FRITax

Frëngjisht: www.fr.ch/scc > Liens internes > Saisie électronique de la déclaration (FRITax)
Gjermanisht: www.fr.ch/kstv > Link Intern > Elektronisches Ausfüllen der Steuererklärung (FRITax)

Kontabilistët që punojnë ne kantonin e Fribourg-ut

www.les-fiduciaires.ch

Tensionet në vendin e punës

Në rast konflikti me punëdhënësin ose me kolegët e punës, mund të merrni këshilla tek Bashkimi Sindikal i Fribourg-ut.

► (22) Bashkimi sindikal i Fribourg-ut

Disa sjellje janë të ndaluara me ligj, posaçërisht në vendin e punës. Janë pikërisht rastet e ngacmimit psikologjik

e seksual, si dhe fjalët, gjestet apo aktet që kanë për qëllim poshtërimin e personave tjerë.

Ngacmimi Seksual

www.harcelementsexuel.ch

► (23) Zyra për barazi burra-gra dhe familje

Jo-diskriminimi

Sipas kushtetutës së Zvicrës: «askush nuk duhet të ndihet i diskriminuar, veçanërisht për shkak të origjinës, racës, gjinisë, moshës, gjuhës, besimit fetar, filozofik ose politik të tij». Nëse ndiheni i dëmtuar prej njëres nga këto arsye, ju këshillojmë të kontaktoni njërën nga organizatat e mëposhtme:

► (1) Zyra për intergrimin e migrantëve dhe parandalimin e racizmit

► (24) Qendra e kontaktit zviceranë- të imigruar / SOS Racizëm-CCSI

► (23) Zyra për barazi burra-gra dhe familje

Puna në të zezë

Edhe personat që herë pas here fitojnë ngapak të holla duke bërë pastrim, punë të shtëpisë, punë kopshti ose duke ruajtur fëmijët konsiderohen si të punësuar. Ata, pra, duhet të lajmërohen te sigurimet sociale nga punëdhënësi ose të lajmërohen vet. Nëse nuk e bëjnë këtë, atëherë bëhet fjalë për punë jo-legale apo në të zezë.

Personi që punon në të zezë nuk është i mbrojtur në rast invaliditeti ose humbje të punës dhe nuk do të përfitojë nga pensioni kur të pensionohet. Pasojat mund të jenë dramatike, për shembull,

ne rast aksidenti në vendin e punës. Është në të mirë të punëdhënësit që personat të cilët i ka punësuar t'i deklarojë te sigurimet sociale. Për të thjeshtëzuar procedurat administrative, ata ose ato mund të drejtohen tek Shoqata kontrolli i punësimit.

► **(25) Shoqata Chèque Emploi-Qendra për integrim socioprofesional**

Puna jo-ligjore

www.pas-de-travail-au-noir.ch

Personat migrantë pa leje qëndrimi

Personat me shtetësi të huaj që nuk kanë leje qëndrimi nuk kanë të drejtë të qëndrojnë ne Zvicër më gjatë se tre muaj. Pas tre muajve, qëndrimi i tyre është i jashtëligjshëm. Ata megjithatë gëzojnë të drejtat themelore: në rast fatkeqësie, për shembull, mund të marrin ndihmën bazë mjekësore ose ndihmë sociale urgjente.

► **(26) Fri-Santé – Zonë trajtimi**

► **(3) Shërbimi për veprim social**

10. Shëndeti

Shëndeti është një e mirë e çmuar që duhet t'a ruajmë.

Sigurimi shëndetësor dhe sigurimi për aksidente (i detyrueshëm)

Nëse keni ardhur nga vendet e jashtme, në parim, keni një muaj kohë që të paraqitni një vërtetim sigurimi te komuna juaj e re. Nëse vini nga ndonjë kanton tjetër, duhet ta paraqitni atë në afatin prej 30 ditësh.

Sigurimi shëndetësor i obligueshëm paguan në rast sëmundje, të lindjes dhe aksidenteve. Megjithatë, personat që punojnë janë të siguar detyrimisht kundër aksidenteve. Në rastin konkret, duhet të jeni të kujdesshëm që të mos siguroheni dy herë ose të jeni i siguar kundër aksidentit në rast të humbjes së punës.

Sigurimi shëndetësor bazë mbulon përkujdesjen mjekësore, medikamentet (ato që figurojnë në listë) dhe qëndrimin në reparte të përgjithshme spitali në tërë kantonin ku banoni. Përveç mbulimit të detyrueshëm, secili mund të bëjë sigurime plotësuese që ofrojnë më shumë përfitime siç është për shembull, qëndrimi në spital në ndarje private.

Sigurimi shëndetësor

Frëngjisht: www.ofsp.admin.ch > Thèmes >

Assurance-maladie

Gjermanisht: www.bag.admin.ch > Themen

> Krankenversicherung

Sigurimi kundër aksidenteve

Frëngjisht: www.ofsp.admin.ch > Thèmes >

Assurance-accident et assurance militaire >

Assurance-accident

Gjermanisht: www.bag.admin.ch >

Themen > Unfall- und Militärversicherung > Unfallversicherung

Shoqëritë siguruese të pranuar

Frëngjisht: www.ofsp.admin.ch > Thèmes

> Assurance-maladie > Assureurs et surveillance > Listes des assureurs-maladie admis

Gjermanisht: www.bag.admin.ch > Themen

> Krankenversicherung > Versicherer und Aufsicht > Verzeichnisse der zugelassenen Krankenversicherer

Informata përkatëse për tarifën e sigurimeve

www.comparis.ch

www.priminfo.ch

Spitali i Fribourg-ut

www.h-fr.ch

Zbritja e tarifave

Shteti lejon zbritje çmimesh për të siguruarit, për çiftet dhe familjet me kushte ekonomike modeste.

Kërkesa për zbritje të tarifave duhet të parashtrahet me plotësimin e formularit zyrtar më së voni deri më 31 gusht të vitit në vijim drejtpërdrejt te Arka e shpërblimit AVS e kantonit të Friburgut në Givisiez. Kjo e fundit nuk shqyrton kërkesat e pranuar pas kalimit të afatit të mbicëkur. Ne, megjithatë, ju përkujtojmë se fillimi i së drejtës lind jo më herët se ditën e parë të muajit në vazhdim në të cilin është parashtruar kërkesa pranë Arkës kantonale të shpërblimit AVS. Formulari i kërkesës është në dispozicion në faqen e internetit të Arkës kantonale të shpërblimeve AVS në adresën e poshtëshënuar.

Frëngjisht: www.caisseavsf.fr > Que faisons-nous > Réduction des primes d'assurance-maladie

Gjermanisht: www.caisseavsf.fr > DE > Was machen wir > Prämienverbilligung in der Krankenversicherung

► **(19) Arka për kompensim e Kantonit të Fribourg-ut**

Personat në situatë të pasigurtë mund të marrin mbështetje dhe këshilla në Fri-Santé. Kjo organizatë siguron çasjen e njerëzve në vështirësi për përkujdesje mjekësore bazë. Edhe Fri-santé është aktive në promovimin e shëndetit dhe parandalim, sidomos me Grisélidis, me profesionistët-et e edukatës seksuale.

► **(26) Fri-Santé – Zonë trajtimi**

► **(27) Grisélidis Fribourg**

Jetëgjatësia

Në mesin e burrave europianë, zviceranët kanë jetëgjatësinë më të lartë. Ata mesatarisht jetojnë 79,4 vjet. Zviceranet me 84,2 vjet vijnë menjëherë pas francezeve (84,4).

Mjekët

Eshtë shumë e këshillueshme që sapo të keni ardhur, të kërkonin një mjek të përgjithshëm ose mjek të familjes. Në rast të problemeve shëndetësore, duhet t'i drejtoheni së pari atij. Mjeku i juaj familjar do t'ju këshillojë, do t'ju shëroj dhe në rast se keni nevojë do t'ju drejtoj te ndonjë specialist. Adresat e mjekëve të përgjithshëm do t'i gjeni në librin e numrave të telefonit, në Internet ose nëpërmes të afërmeve tuaj.

Lista e Shoqërisë së Mjekësisë e kantonit të Fribourg-ut
www.smcf.ch

Shërbimi i mjekut kantonal

Frëngjisht: www.fr.ch/smc > Migrants
 Gjermanisht: www.fr.ch/kaa > Migranten

Urgjenca

Në rast urgjence, nëse nuk mund të kontaktoni mjekun e familjes, mund të kontaktoni mjekun kujdestar të distriktit (rrethit) tuaj ose njërin nga spitalet e kantonit. Për raste kritike duhet të thërrisni në numrin 144.

Mjeku kujdestar	
Distrikti Sarine / Saane	026 350 11 40
Distrikti Glâne	026 350 11 40
Distrikti Gruyère / Greyerz	026 350 11 40
Distrikti Lac / See	0900 670 600
Distrikti Veveyse / Vivisbach	021 948 90 33
Distrikti Singine / Sense / Sense	026 418 35 35
Distrikti Broye	026 660 63 60

Spitalet e Fribourg-ut, HFR – www.h-fr.ch	
Fribourg	026 426 71 11
Billens	026 651 61 11
Riaz	026 919 91 11
Meyriez / Murten	026 672 51 11
Châtel-St-Denis	021 948 31 11
Tafers	026 494 44 11

Spitali ndërkantonal Broye Fribourg – www.hopital-broye.ch	
Payerne	026 662 80 11
Estavayer-le-Lac	026 664 71 11

Kujdesi për dhëmbët

Kujdesin e përgjithshëm për dhëmbë, siç është për shembull, mbushja me rastin e kariesit, parodontitit ose korrigjimin e pozitës së dhëmbëve (aparartet për dhëmbë) nuk e merrë përsipër sigurimi shëndetësor bazë. Nëse keni fëmijë, është mundësia që të bëni sigurimin për dhëmbë para

se atyre t'iu paraqiten problemet eventuale.

Të theksojmë se Shërbimi dentar shkollor u ofron kujdesin për dhëmbë fëmijëve që vijojnë shkollimin e obligueshem si dhe fëmijëve që janë në kopsht.

► **(28) Shërbimi dentar shkollor**

Urgjenca për dhëmbët

Fribourg /Freiburg, Sarine /Saane, Singine /Sense dhe Lac /See	0848 14 14 14 026 322 33 43
Glâne, Gruyère /Greyerz, Veveyse / Vivisbach	026 919 35 30
Broye	0848 133 133

Personat e moshuar

Për të marrë informata lidhur me mbështetjen e personave të moshuar që kanë nevojë për përkujdesje ose shoqërim, mund të drejtoheni te njëra nga organizatat e mëposhtme:

- **(29) Shoqata e Fribourg-ut e institucioneve për persona të moshuar – AFIPA**
- **(30) Shoqata e Fribourg-ut për ndihmë dhe trajtim në shtëpi**
- **(31) Pro Senectute Fribourg**

Shërbimi për parashikim social

www.fr.ch/sps

Personat me aftësi të kufizuara

Personat me të meta fizike dhe psiqike si dhe personat përgjegjës për ta, mund të gjejnë këshilla dhe përkrahje duke iu drejtuar Zyrës për Sigurime Invalidore të kantonit (Office d'Assurance-Invalidité), te Pro Infirmisi ose, nëse kemi të bëjmë me fëmijët, te Shërbimi edukativ lëvizës (Service éducatif itinéraire).

► **(32) Zyra për sigurim invalidor e kantonit të Fribourg-ut**

► **(33) Pro Infirmis – Service Fribourgeois**

► **(34) Shërbimi edukativ lëvizës**

Planifikimi i familjes dhe informatat seksuale

Nëse keni pyetje në lidhje me jetën tuaj seksuale, mund t'iu drejtoheni Sektorit planifikues familjar dhe informata seksuale. Aty do t'ju këshillojnë me gjithë dëshirë për kontracepcionin, seksualitetin, orientimin seksual, shtatzëninë, ndërprerjen e shtatzënisë, infeksionet seksuale që transmetohen, abuzimet seksuale, jetën emocionale dhe relacionale. Bisedat janë falas dhe rreptësisht konfidenciale. Gjithashtu do ta keni mundësinë që të kryeni kontrolë gjinekologjike ose teste të zbulimit të ndonjë sëmundje.

► **(35) Sektori për planifikim familjar dhe informata seksuale**

► **(36) Qendra për përkrahje dhe parandalim në fushën e HIV /SIDA dhe IST**

11. Martesa dhe jeta familjare

Në kantonin e Fribourg-ut, Shteti dhe komunat ofrojnë mbështetje të rëndësishme për familjet dhe fëmijët.

Martesa

Në Zvicër, që të mund të martohesh, duhet të jeshë 18 vjeç. Njihen vetëm martesat e lidhura në Zyrën e gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile në distriktin tuaj ose shërbimi i gjendjes civile dhe natyralizimeve do t'ju informojnë për kushtet që duhet plotësuar dhe për dokumentet e nevojshme. Nëse dëshironi që burri juaj i ardhshëm apo gruaja ose anëtarë tjerë të familjes t'ju bashkohen në Zvicër, duhet të kontaktoni Shërbimin për popullësi dhe migrantë.

Zyrat e gjendjes civile në kantonin e Fribourg-ut

Frëngjisht: www.fr.ch/secin > Etat civil >

Nos offices d'état civil

Gjermanisht: www.fr.ch/zea >

Zivilstandsamt > Zivilstandsamt

- ▶ **(37) Shërbimi i gjendjes civile dhe natyralizimeve**
- ▶ **(4) Shërbimi për popullatë dhe migrantë**

Frëngjisht: www.familles-fribourg.ch >

Vivre ensemble

Gjermanisht: www.familien-freiburg.ch >

Zusammenleben

Martesat binacionale

Më shumë se një e treta e martesave në Zvicër janë binacionale.

Partneriteti i regjistruar

Personat e gjinisë së njëjtë kanë mundësinë që t'a bëjnë të njohur bashkimin e tyre duke hyrë në një partneritet të regjistruar. Për t'u njohur me hapat që duhet ndërmarrë, ata duhet të kontaktojnë Zyrën e gjendjes civile të distriktit në të cilin jeton njëri ose tjetri nga pala e interesuar.

- ▶ **(38) Sarigai – Shoqata e Friburgut për personat lesbike, gays, bi dhe trans* (LGBT*)**

Zyrat e gjendjes civile të kantonit të Fribourg-ut

Frëngjisht: www.fr.ch/secin > Etat civil >

Nos offices d'état civil

Gjermanisht: www.fr.ch/zea > Zivilstandsamt >

Zivilstandsamt

Frëngjisht: www.familles-fribourg.ch >

Vivre ensemble

Gjermanisht: www.familien-freiburg.ch >

Zusammenleben

12. Harta e kantonit të Friburgut dhe numrat e urgjencës (që shkëputen)

Kantoni i Fribourg-ut shkurtimisht

Sipërfaqja: 1592 km²

Popullësia: 300000 banorë

Gjuhët zyrtare: frëngjisht, gjermanisht

Kryeqyteti: Fribourg

7 Distrikte (Rrethe) – 163 komuna (2014)

Web-faqja e kantonit të Fribourg-ut

www.fr.ch

Zyra për integrim të migrantëve-eve dhe parandalim të racizmit

Bureau de l'intégration des migrant-e-s

et de la prévention du racisme IMR

Fachstelle für die Integration der MigrantInnen


und für Rassismusrävention IMR

www.fr.ch/integration

integration@fr.ch

T: 026 305 14 85

Harta e Kantonit të Fribourg-ut 2014



Urgjencat për tërë Zvicrën

Policia.....	117
Zjarrëfikësit (zjarri,uji,gazi).....	118
Ambulanca.....	144
Dora e zgjatur (shqetësime psikike).....	143
Informacione toksikologjike (helmimi, helmi).....	145

Nëse jeni në situatë urgjence

- Ruajeni qetësinë
- Identifikoni rreziqet
- Strehohuni (largohuni nga rreziku)
- Kërkoni ndihmë
- Ofroni ndihmë



Martesa e detyruara

Askush nuk duhet të detyrohet, as nga familja ose nga kushdo qoftë që të martohet kundër vullnetit. Martesa e detyruar është shkelje e rëndë e lirisë personale. Është shkelje e të drejtave themelore të qenies njerëzore, të drejta që mbrohen nga Kushtetuta Zvicerane dhe Kushtetuta e Fribourg-ut.

Ndihmë për gratë

- ▶ (39) **Shoqata Solidarité Femmes – Qendra LAVI për gra viktima të dhunës dhe akteve kriminale**

Ndihmë për burrat

- ▶ (40) **Qendra për konsultime LAVI për fëmijë, burra dhe viktima të trafikut**

Lindja

Çdo lindje duhet të lajmërohet tek Zyra e gjendjes civile e distriktit tuaj. Nëse fëmiju lind në spital, atëherë spitali do ta lajmërojë atë. Nëse lindja ka ndodhur në shtëpi, këtë do ta bëjnë prindërit. Që nga lindja, fëmiju është automatikisht i siguruar kundër sëmundjes përgjatë tre muajve. Gjatë kësaj periudhe, prindërit duhet të bëjnë sigurimin shëndetësor në emër të tij.

- ▶ (35) **Spektori për planifikim familjar dhe informata seksuale**
- ▶ (41) **Shoqata Zyra Familjare Fribourg**

Ndihmë për nënat e ardhshme

www.sosfuturesmamans.ch

Pushimi dhe shtesat e lehonisë

Pas lindjes, gratë që janë në marrëdhënie pune kanë të drejtë për pushim lehonie së paku 14 javë. Gjatë kësaj periudhe, ato mund të marrin së paku 80% nga paga e tyre. Për këtë, duhet kontribuar në sigurimet sociale gjatë 9 muajve para lindjes dhe të keni punuar së paku 5 vite. Ndërsa, prej 1 korrikut 2011, kantoni i Friburgut e ka vendosur një shtesë të lindjes e cila plotëson sistemin federal dhe i cili i ka të bëjë edhe me gratë që nuk janë në marrëdhënie pune para lindjes. Periudhat e sigurimeve dhe të punës në shumicën e vendeve europiane merren parasysh gjithashtu. Informata më të detajuara në lidhje me këtë, do t'ju ofrojë Arka për kompenzim e kantonit të Fribourg-ut.

- ▶ (19) **Fondi për kompensim i kantonit të Fribourg-ut**

Shtesat e lehonisë në nivelin federal

Frëngjisht: www.ofas.admin.ch > Thèmes > APG/Maternité > Données de base > Droit à l'allocation de maternité APG
Gjermanisht: www.bsv.admin.ch > Themen > EO/Mutterschaft > Grundlagen > Anspruch auf Mutterschaftsgeld der EO

Shtesat e lehonisë në nivelin kantonal

Frëngjisht: www.caisseavsfr.ch > Allocation de maternité cantonale > Informations > Informations en bref (formen pdf)
Gjermanisht: www.caisseavsfr.ch > DE > Kantonale Mutterschaftsbeiträge > Informationen > Kurzinformationen (formen pdf)

Shtesat për fëmijë

Nëse keni fëmijë, keni të drejtë të merrni shtesa për ta. Në kantonin e Fribourgut, për fëmijët deri në moshën 16 vjeçare, do të merrni shumën prej 245 frangash në muaj për dy fëmijët e parë, ndërsa 265 franga prej fëmijut të tretë. Për të rinjët e moshës deri në 25 vjeç, që janë duke u shkolluar, shuma është 305 franga në muaj, ndërsa 325 franga prej fëmijut të tretë (2014). Në parim, shtesat e fëmijëve paguhen nga punëdhënësi në të njëjtën kohë me pagën mujore. Në kushte të caktuara edhe prindërit që nuk janë në marrëdhënie pune mund të marrin shtesa për fëmijë. Informata në lidhje me këtë do t'ju ofrojë Arka për kompensim e kantonit të Fribourg-ut.

Frëngjisht: www.guidesocial.ch > Consulter le droit cantonal > Chercher > allocations familiales fribourg (FR)

Frëngjisht: www.caisseavsf.fr.ch > Que faisons-nous > Allocations familiales

Gjermanisht: www.caisseavsf.fr.ch > DE > Was machen wir > Familienzulagen

► (19) Arka për kompensim e kantonit të Fribourg-ut

Të drejtat e fëmijëve dhe të rinjëve

Sikur të rriturit edhe fëmijët dhe të rinjët, vajzat dhe djemtë i kanë të drejtat themelore. Ata dhe ato në veçanti kanë të drejtën e mbrojtjes kundër keqtrajtimit, dhunës, abuzimeve seksuale dhe shfrytëzimit në punë si dhe të drejtën për edukim dhe për një nivel të mjaftueshëm jetësor (banim,

veshmbathje, ushqim). Prindërit nuk kanë të drejtë t'i irrahin fëmijët dhe të rinjët, njëjtë sikur ata ose ato që nuk kanë të drejtë t'a godasin këdo qoftë. Gjymtimi seksual i femrave është i ndaluar. Drejtësia dënon ashpër aktet e tilla edhe nëse ato ndodhin brenda familjes apo gjatë qëndrimit jashtë vendit.

► (42) Shërbimi për fëmijë dhe të rinjë

► (35) Sektori planifikimi familjar dhe informata seksuale

► (40) Qendra për konsultime LAVI për fëmijë, burra dhe viktimat të trafikut

Të drejtat dhe mbrojtja e fëmijëve dhe e të rinjëve

Frëngjisht: www.fr.ch/sej > Droits de l'enfant
Gjermanisht: www.fr.ch/ja > Rechte des Kindes

Frëngjisht: www.fr.ch/sej > Protection des enfants et des jeunes

Gjermanisht: www.fr.ch/ja > Kinder- und Jugendschutz

Web-faqja e informatave për të rinjë

Frëngjisht: www.ciao.ch

Gjermanisht: www.tschau.ch

Çiftet dhe familjet në vështirësi

Personat që hasin në vështirësi brenda çiftit ose me fëmijët e tyre mund të gjejnë ndihmë duke kontaktuar Shoqatën Zyra familjare (Office familial). Në rast ndarje apo shkurorëzimi, prindi i cili nuk i ka fëmijët në përkujdesje duhet të paguaj një pension mujor për mbështetjen e tyre e nganjëherë edhe të prindit tjetër.

► (41) Shoqata Zyra familjare Fribourg

► (43) Shoqata espacefemmes

Frëngjisht: www.familles-fribourg.ch >

Difficultés dans le couple

Gjermanisht: www.familien-freiburg.ch >

Eheprobleme

Ndonjëherë, njëri anëtar i çiftit është dashur që të lë vendin e origjinës dhe familjen e tij. Ai ose ajo duhet të përshtatet në vendin e ri dhe të krijojë një rreth të njohurish, gjë e cila nuk është gjithmonë e lehtë. Shoqatat espacefemmes dhe Frabina mund t'ju ofrojnë ndihmë dhe këshilla të nevojshme.

► **(43) Shoqata espacefemmes**

► **(44) Frabina - Këshillimore për gra dhe çifte binacionale**

Dhuna në familje

Në Zvicër, përdorimi i dhunës brenda në familje është gjithashtu i ndaluar. Dhuna në familje mund të jetë fizike (goditje), psikologjike (kërcënime), seksuale (detyrime) ose ekonomike (privim i të hollave). Nëse ndodhin sjellje të tilla brenda çiftit ose ndaj fëmijëve, në shtëpi apo diku tjetër, drejtësia mund të ndërhyjë edhe nëse viktimat nuk ka bërë ankesë. Autori i dhunës në familje iu nënshtrohet dënimeve të rënda.

Çdo viktimë mund të kërkojë këshilla falas ose ndihmë të njëra nga qendrat e konsultimit LAVI (Ligji për ndihmë viktimave). Personat që kanë tendencë dhune mund t'i drejtohen Shoqatës EX-pression. Personeli i këtyre organizatave respekton fshehtësinë më të madhe.

► **(39) Shoqata Solidarité Femmes - Qendra LAVI për gra viktimat të dhunës dhe akteve kriminale**

► **(40) Qendra për konsultim LAVI për fëmijë, burra dhe viktimat të trafikut**

► **(45) Shoqata EX-pression Fribourg**

Frëngjisht: www.familles-fribourg.ch >

Violence domestique

Gjermanisht: www.familien-freiburg.ch >

Häusliche Gewalt

13. Edukimi dhe shkollimi i detyrueshëm

Autoritetet e Fribourg-ut i japin rëndësi të madhe cilësisë së edukimit të fëmijëve.

Në Zvicër, sistemet shkollore ndryshojnë nga njëri kanton në tjetrin. Në kantonin e Fribourg-ut, shkollimi është i detyrueshëm dhe falas për fëmijët nga mosha 4 vjeçare deri në moshën 15 vjeçare.

Edukimi dhe përgatitja shkollore në kantonin e Fribourg-ut

www.fr.ch/dics

www.edufr.ch

Përgjegjësia prindërore

Prindërit kanë përgjegjësinë kryesore për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre. Ata kanë për obligim që t'i shkollojnë fëmijët, që t'i bëjnë të respektojnë oraret e mësimi dhe rregullat e jetës shkollore dhe të bashkëpunojnë me shkollën. Nëse nga shkolla ju ftojnë për bisedë individuale ose në mbledhje të prindërve, është me rëndësi që të shkoni aty. Kjo mund të jetë shumë e nevojshme për të gjetur zgjidhje në rast se fëmiju juaj ka hasur në ndonjë vështirësi ose duhet bërë zgjedhje për të ardhmen e tij.

- ▶ **(42) Shërbimi për fëmijë dhe të rinjë**
- ▶ **(46) Edukata familjare**

Ruajtja e fëmijëve dhe përkujdesja jashtë-shkollore

Prindërit që janë në marrëdhënie pune shpesh kanë nevojë që dikush të përkujdeset për fëmijët e tyre gjatë ditës, gjatë pushimit të drekës, pas mësimi ose gjatë pushimeve shkollore. Komuna juaj do t'ju informojë me gjithë dëshirë për mundësitë e ruajtjes së fëmijëve dhe përkujdesje jashtë-shkollore që janë në regjionin tuaj.

- ▶ **(47) Federata e Fribourg-ut për përkujdesje familjare ditore**
- ▶ **(48) Federata e Fribourg-ut për çerdhe dhe kopshte fëmijësh**

Edukimi parashkollor (nga mosha 4 vjeçare)

Në kantonin e Fribourg-ut, fëmijët mund të pranohen në çerdhe (garderie) nga mosha 2 vjeçare ose në një kopsht (école maternelle) dhe duhet që domosdoshmërisht të integrohen në kopsht fëmijësh (école enfantine) nga mosha 4 vjeçare. Kjo periudhë është e rëndësishme. Fëmiju juaj do të mësojë të krijojë kontakte duke folur gjuhën lokale.

Shkolla fillore (nga mosha 6 vjeçare)

Shkolla fillore nis nga mosha afërsisht 6 vjeçare. Mësimi është i përqëndruar në gjuhë, matematikë, ambient, muzikë, aktivitete krijuese dhe sport. Në moshën 11-12 vjeçare, fëmiju juaj do t'i nënshtrohet provimit që në veçanti do t'i testojë aftësitë e tij në frëngjisht (gjermanisht për gjermanofolësit) dhe matematikë. Rezultatet e marra do ta përcaktojnë shtegun që fëmiju do ta ndjekë më tutje.

Pedibus i në kantonin e Fribourgut

Në shumë komuna të Fribourg-ut, ekziston sistemi i shoqërimit të fëmijëve nga prindërit për të shkuar në shkollë këmbë, i ashtuquajtur Pedibus. Fëmijët shkojnë në kohë të caktuar në një stacion të shënuar në panel, sikur për të marrë autobusin. Aty, ata takojnë shokët e tyre të fshatit ose të lagjes dhe marrin rrugën për në shkollë nën përcjelljen e një prindi. Prindërit i shoqërojnë fëmijët secili me radhë. Përparsia është se prindërit nuk duhet më t'i dërgojnë vet fëmijët e tyre në shkollë shumë herë gjatë ditës.

www.pedibus.ch

Cikli orientues – shkolla e mesme (nga mosha 12 vjeçare)

Që nga mosha 12-13 vjeçare fëmiju juaj do të hyjë në një nga tri kategoritë e ciklit orientues:

- **Klasat bazë:** Nxënësit që kanë nevojë t'i përforcojnë njohuritë e

tyre bazë,

- **Klasat e përgjithshme:** Nxënësit që planifikojnë përgatitje profesionale,
- **Klasat parajimnaziale:** Nxënësit që planifikojnë të bëjnë studime të larta.

Fëmijët mund të kalojnë nga njëra kategori në tjetrën sipas rezultateve të tyre.

Orientimi shkollor dhe profesional

Është e rëndësishme që të rinjtë të jenë të informuar mirë për mundësitë e praktikës (stage) dhe të arsimimit (formation) para vitit të fundit të shkollës fillore. Për t'i ndihmuar që ta bëjë zgjedhjen në mesin e shumë mundësive që ekzistojnë, fëmiju do të ketë nevojë për mbështetjen tuaj. Një konsultim me specialistin për orientim është gjithashtu i mundur. Sekretariati i shkollës do t'ju jap më gjithë dëshirë adresën e Qendrës për orientim shkollor dhe profesional të regjionit tuaj.

Qendrat regionale për orientim shkollor dhe profesional

Frëngjisht: www.fr.ch/sopfa > Centres d'orientation > Centres régionaux

Gjermanisht: www.fr.ch/bea >

Berufsberatungsstellen > Regionale Stellen

Informata në gjuhë të huaja për orientim profesional

Frëngjisht: www.orientation.ch >

Choix professionnel > Informations en langues étrangères

Gjermanisht: www.berufsberatung.ch >

Berufswahl > Informationen für

Fremdsprachige

► **(49) Shërbimi për orientim profesional dhe përgatitje të të rriturve**

Nxënësit me origjinë të huaj dhe nxënësit shqipfolës

Nxënësit të cilët nuk flasin gjuhën e përdorur në shkollë ndjekin kurse të gjuhës dhe mbështetje të adaptuar sipas nevojës së tyre paralelisht me një hyrje në klasen e rregullt.

► **(50) Koordinatorja për shkollimin e fëmijëve të migrantëve dhe kurseve të gjuhës dhe kulturës së vendit të origjinës**

Fëmiju juaj mund gjithashtu të ndjek kurse të gjuhës dhe kulturës së origjinës së tij, të organizuara nga konsolata e vendit ose nga anëtarët e komunitetit tuaj.

Frëngjisht: www.fr.ch/senof > Migration et intégration > Cours de langue et culture d'origine (LCO)

Gjermanisht: www.doa.ch > Migration und Integration > Kurse in «Heimatlicher Sprache und Kultur» (HSK)

Është e mundur huazimi i librave në më shumë se 200 gjuhë në bibliotekën ndërkulturore LivrEchange.

► **(14) Biblioteka ndërkulturore LivrEchange**



14. Përgatitja profesionale dhe studimet e specializuara (nga moshë 16 vjeçare)

Zvicra ka një sistem të arsimit profesional të quajtur «dual». Nxënësit zgjedhin në mes të një zanati apo të shkollës së mesme superiore.

Zanati (mësimi) në ndërmarrje (nga moshë 16 vjeçare)

Një ose dy ditë në javë, nxënësi ndjek mësimet në shkollën profesionale. Pjesa tjetër e javës i përkushtohet zhvillimit të aftësive praktike të punës në ndërmarrje.

Nxënësi është i punësuar në bazë të një kontrate nga punëdhënësi i tij, i cili edhe do ta paguaj për punën e bërë.

Mësimi (zanati) zgjatë 2 deri 4 vite dhe çon tek marrja e një çertifikate federale (AFP/EBA) ose të një çertifikate federale të aftësive (CFC/EFZ). Këto diploma njihen në tërë Zvicrën.

Skema e sistemit zviceran për arsimim

Frëngjisht: www.orientation.ch > Formation >

Schéma du système suisse de formation

Frëngjisht: www.fr.ch/sopfa > Formations

Gjermanisht: www.fr.ch/bea > Ausbildungen

Kërkimi i vendeve për zanate

Frëngjisht: www.orientation.ch > Formation >

Toutes les places d'apprentissage

Gjermanisht: www.berufsberatung.ch >

Berufswahl > Lehrstellensuche

Ndërmarrjet e arsimit (Enterprises formatrices)

Në kantonin e Fribourg-ut më shumë se 3600 ndërmarrje punësojnë dhe përgatisin (arsimojnë) nxënësit në më shumë se 150 profesione të ndryshme.

Gjatë ose pas mësimet të zanatit, të rinjtë mund të studiojnë për të marrë diplomën e maturës profesionale. Ky titull hapë rrugë për një shkollë të lartë të specializuar (HES), shkollë të lartë (superiore) ose mundëson marrjen e një patente ose diplome federale.

Të rinjtë e moshës madhore me origjinë të huaj

Të rinjtë që vijnë nga vendet e huaja e që nuk e kanë më moshën që të vijnë shkollën e mesme mund të ndjekin kurset për integrim, të organizuara nga Shërbimi për përgatitje profesionale. Këto kurse kanë për qëllim të ndihmojnë të rinjtë për pranimin e tyre për arsimim profesional.

► (10) Shërbimi për përgatitje profesionale

► (49) Shërbimi për orientimin profesional dhe përgatitje të të rriturve

Shkolla e mesme e lartë e shkallës së dytë (nga moshë 16 vjeçare)

Pas shkollimit të detyrueshëm nxënësit mund të vijnë me orar të plotë shkollimin e kulturës së përgjithshme, shkollë të tregtisë, shkollimin për maturë profesionale ose gjimnazin.

	Kohëzgjatja	Diploma
Shkolla për kulturë të përgjithshme	3 vite	Çertifikata për kulturë të përgjithshme
Shkolla e tregtisë	4 vite	Çertifikatë federale të aftësisë + Maturë profesionale të tregëtisë
Shkolla për maturë profesionale	4-5 vite	Matura profesionale
Gjimnazi / Kolegji	4 vite	Çertifikata e maturës gjimnaziale

Matura profesionale

Frëngjisht: www.orientationfr.ch > Formations > Maturité professionnelle

Gjermanisht: www.berufsberatungfr.ch > Ausbildungen > Berufsmaturität

Shërbimi i arsimimit të mesëm i shkallës së dytë (shkolla e kulturës së përgjithshme, shkolla e tregtisë dhe gjimnazi)

www.fr.ch/s2

Studimet e larta

Ai ose ajo që ka mbaruar gjimnazin dhe ka marrë çertifikatë të pjekurisë

nga gjimnazi mund të pranohet në universitet, në shkollat politike federale ose në shkollat e larta të specializuara (për këto të fundit kërkohet, një stazh ose provimi pranues). Për të gjitha informatat, studentët mund t'i drejtohen Shërbimit për praninë dhe regjistrim në Universitetin e Fribourg-ut. Një person që ka ardhur nga vendet e huaja nuk pranohet menjëherë edhe nëse ai ka qenë i pranuar në një nga universitetet e vendit të tij të origjinës.

Universiteti i Fribourg-ut

www.unifr.ch

Ekuivalenca e titujve për çasje në universitete zvicerane

Frëngjisht: www.crus.ch > Français >

Reconnaissance/Swiss ENIC

Gjermanisht: www.crus.ch > Anerkennung/Swiss ENIC

I vetmi në botë

Universiteti i Fribourg-ut është i vetmi në botë që është dygjuhësh Frëngjisht-Gjermanisht.

Bursat për studime dhe për arsimim

Në kushte të caktuara është e mundur marrja e një burse për arsimim ose për studime. Informatat në lidhje me këtë mund t'i merrni duke kontaktuar drejtpërdrejtë institucionin për shkollim përkatës, administratën e komunës suaj ose shërbimin për subvencione të arsimimit.

► (51) Shërbimi i subvencioneve për shkollim

Njohja e diplomave dhe e çertifikatave

Nëse dëshironi që t'ju njihet diploma e marrë në një vend të huaj, duhet ti drejtoheni Zyrës federale për arsimim profesional dhe teknologji (Office fédéral de la formation professionnelle et de la technologie).

Njohja ndërkombëtare e diplomave

Frëngjisht: www.sefri.admin.ch >

Reconnaissance de diplômes étrangers

Gjermanisht: www.sbf.admin.ch >

Anerkennung ausländischer Diplome

Ndoshta keni përvojë profesionale më të gjatë se 5 vite. Në këtë rast është e mundur, në kushte të caktuara, që të vlerësohet përvoja juaj dhe të merrni titull profesional që njihet në Zvicër. Shërbimi për orientim profesional dhe arsim të të rriturve do t'ju japë me dëshirë informata në lidhje me këtë.

► (49) Shërbimi për orientim profesional dhe përgatitje të të rriturve

Vlerësimi i çertifikatave

Frëngjisht: www.orientationfr.ch > Prestations détaillées > Adultes > Validation des acquis

Gjermanisht: www.berufsberatungfr.ch >

Dienstleistungen > Erwachsene > Validierung von Bildungsleistungen

Shkollimi i të rriturve dhe shkollimi i vazhduar

Në Zvicër, shumica e të rriturve vijojnë kurse për arsimim të vazhduar e që kanë për qëllim zhvillimin e njohurive të tyre profesionale ose përfitim të njohurive të reja. Këto përgatitje nganjëherë financohen nga ndërmarrja. Një person që arsimohet përgjatë gjithë karrierës së tij profesionale ka më shumë përparësi që të gjejë punën që atij i pëlqen. Informohuni te punëdhënësi juaj.

Arsimimi i vazhduar në Zvicër

www.formation-continue.ch

Web-faqja e qendrës për zhvillim ndërprofesional

www.cpi.ch

15. Mbrojtja e ambientit

Popullata e Fribourg-ut i kushton rëndësi të madhe mirëmbajtjes së peizazhit, respektimit të vendeve publike dhe mbrojtjes së ambientit.

Pasuritë e një mjedisi të ruajtur

Kantoni i Fribourg-ut ka traditë të lartë bujqësore. Duke përfaqësuar 3% të popullatës së Zvicrës, kantoni furnizon vendin me 10% të prodhimeve bujqësore. Falë mënyrës së prodhimit duke respektuar mjedisin, bujqësia e Friburgut furnizon popullatën me një gamë të gjerë të prodhimeve të shëndosha, cilësore dhe nga afërsia, të cilat i gjejmë në tregjet e qytetit dhe në fshatra, drejtëpërsëdrejti në fushat e prodhimit (shitja e drejtëpërdrejtë), e gjithashtu edhe në disa dyqane dhe supermarkete. Konsumimi i këtyre prodhimeve të afërsisë është mënyra më e mirë për ta njohur territorin e Friburgut. Respektimi i tokave nga bujqit kontribuon gjithashtu në cilësinë e shkëlqyeshme të ujit të rubinetave gjithandej kantonit të Friburgut.

Mirëmbajtja e peizazhit

Puna bujqësore dhe ajo pyjore i kanë dhënë formë peizazhit të Fribourg-ut gjatë gjithë shekujve. Kjo punë meriton respekt. Është e ndaluar, për shembull, të kalosh në mes fushave të punuara, të dëmtosh drunjët, t'i frikësosh kafshët ose të hudhësh plehra në natyrë.

Dardha me shije nga Italia

Në kantonin e Fribourg-ut, bujqit kultivojnë që moti një dardhë të vogël të quajtur «Botzi», që ka kuptimin «Grappe de poires» (Kalavesh dardhash). Në gjermanisht termi «Büschellbirne» i përshatet plotësisht këtij kuptimi. Që nga viti 2007 ky frut është i mbrojtur me Emërtimin e originës AOC (Appellation d'origine contrôlée AOC). Nuk dihet origjina e saj. Disa thonë që mercenarët e Fribourg-ut do ta kenë sjellë nga regjioni i Napolit të Italisë, në shekullin XVII.

Respektimi i vendeve publike

Çdo komunë ka një rregullore policie e cila informon popullatën për sjelljet që duhet të ketë në vendet publike dhe ndaj personave të tjerë. Kjo rregullore sqaron, për shembull, që mbeturinat duhet të hudhen në shportë mbeturinash, që është e ndaluar të bësh zhurmë pa nevojë ose cilat masa duhet marrë që kafshët shtëpiake të mos pengojnë. Një kopje nga rregullorja e policisë mund ta kërkonti te administrata komunale.

Riciklimi i mbeturinave

Në kantonin e Fribourg-ut ndarja e mbeturinave bëhet me shumë kujdes.

Të gjitha komunat kanë vendet e mbeturinave në të cilat bëhet ndarja e tyre sipas llojit, për shembull qelaji (xhami), letra, kartoni, metali, bateritë, vajërat, materiet organike, aparatet shtëpiake dhe prodhimet toksike. Gati gjysma e mbeturinave të mbledhura kështu, riciklohen. Pjesa e mbetur digjet por duke u respektuar ambienti. Komuna juaj do t'ju informojë me gjithë dëshirë për infrastrukturen e vënë në dispozicion.

Mbledhja e mbeturinave, specialitet zvicëran

Në Zvicër, 95% të qelqit, 90% të aluminit dhe 80% të letrës së përdorur mbledhen për t'u ricikluar.

mbeturinave që riciklohen siç është qelqi, letra, PET-i, kutitë e konservave, etj., që eliminohen falas. Është rreptësisht e ndaluar djegia e mbeturinave brenda shtëpive ose në ambient të hapur.

► (52) Shërbimi për ambient

Mbeturinat që nuk riciklohen

Komuna juaj do t'ju informojë për ditët e mbledhjes së mbeturinave shtëpiake që nuk riciklohen dhe do t'ju tregojë ku dhe kur t'i vendosni thasët jashtë si dhe ku mund t'i merrni thasët e komunës për mbeturina (Sacs-poubelles communaux). Sipas komunës në të cilën banoni do të paguani taksën për thasët zyrtarë të mbeturinave (Sacs-poubelles officiels) ose një taksë për eliminimin e mbeturinave tuaja. Këto informata mund t'i gjeni shpesh në web-faqet e Internetit të komunave. Disa nga komunat ofrojnë një numër thasësh falas, varësisht prej anëtarëve të familjes. Qëllimi i komunave është që të nxisin ndarjen më të mirë të



16. Jeta shoqërore dhe asociative

Argëtimi dhe rekreacioni (pushimi) janë të rëndësishme. Ato na ndihmojnë të çlodhemi, të mësojmë, të jemi në formë dhe të krijojmë miqësi të reja.

Festat popullore të Fribourg-ut

Festat popullore kryesore të Fribourg-ut bëhen në vjeshtë dhe dimër. Në muajt shtator-tetor zbresin tufat e lopëve pas 4 muajve të kaluar në kullotat malore. Këtë e quajmë Désalpe. Mund të merrni pjesë në festat e organizuara me këtë rast, sidomos në Semsales, Charmey, Schwarzsee dhe Albeuve. Kryesisht në shtator-tetor, banorët e Fribourg-ut bëjnë festën e quajtur Bénichon e cila shënon fundin e punëve bujqësore. Është ky një rast për të shijuar specialitetet e Fribourg-ut duke ngrënë së bashku një drekë tradicionale që mund të zgjasë më tepër se 6 orë.

Të shtunën e parë të muajit dhjetor, popullata e qytetit të Fribourg-ut feston Saint-Nicolas. Me këtë rast, një student i veshur në rroba si Saint-Nicolas kalon nëpër qytet hipur mbi gomar dhe u shpërndanë fëmijëve ëmbëlsira. Me të arritur në katedrale, ai i drejtohet publikut me një fjalim satirik të frymëzuar nga ngjarjet e vitit të lënë pas. Më shumë se 20000 persona marrin pjesë në kortezh.

Në muajin shkurt, shumë qytete të kantonit festojnë karnevalin për të lajmëruar ardhjen e stinës së pranverës.

Saint-Nicolas

Saint-Nicolas (I Shejti Nikolla) ishte Peshkop i një vendi të quajtur Myre, në Turqi. Ai është mbrojtësi i shenjtë i qytetit dhe kantonit të Fribourg-ut, e gjithashtu edhe i lundrimit, i fëmijëve dhe i kasapëve.

Jeta kulturore dhe sportive

Jeta kulturore në Fribourg është shumë e pasur. Kantoni ka shumë muze dhe salla spektaklesh. Aty mbahen gjithashtu shumë manifestime kulturore. Disa janë ndërkombëtarisht të njohura siç është Festivali ndërkombëtar i filmit në Friburg, Takimet ndërkombëtare të folklorit (RFI). Në veçanti, shoqëritë muzikore dhe të këngës janë të shumëta. Të gjitha informatat kulturore do të mund t'i gjeni duke iu drejtuar Zyrës për turizëm të regjionit tuaj ose të administrata e komunës suaj. Ka zgjedhje të gjërë të aktiviteteve sportive, qoftë për fëmijë, të rinjë, të rritur ose persona të moshuar. Komuna juaj do t'ju informojë për mundësitë që janë në regjionin tuaj.

Jeta kulturore dhe sportive në kantonin e Fribourg-ut

www.fribourgregion.ch

Shoqata e Fribourg-ut për Sport

www.afs-fvs.ch

Një traditë e njohur ndërkombëtare, nxitur nga Jo Siffert, ish-pilot i

Fribourg-ut për ngjarjen e veturave

Prej kur pilotët shkundin shishen e shampanjës mbi podium, në përfundim të një gare?

Prej 11 qershorit 1967. Kjo datë përkon me ardhjen e 24 Heures du Mans.

Jo Siffert, fitues për të dytën herë me radhë i indeksit të performancës, ka vështirësi për heqjen e tapës të shishes së shampanjës. Pastaj, atij i lind ideja që të shkund shishen dhe t'i spërkas pilotët të cilët ishin me të mbi podiumin e 24 Heures du Mans.

www.josiffert.com

Ngjarjet sportive më të njohura

- «**Morat-Fribourg**»: Vrapimi më i njohur në kanton që nga viti 1933. Çdo të dielë të parë të muajit tetor, afër 8000 persona vrapojnë 17 km, distancë kjo që i ndanë dy atytetet.

www.morat-fribourg.ch

- «**slowUp**»: Vetëm ose me familje, ditët e zbulimit të rajoneve tërheqëse pa automjete të motorizuara (biçikleta, patina me rrotë, etj).

www.slowup-gruyere.ch

www.slowup-murtensee.ch

Ecja këmbë

Ecja në male është sporti më i popullarizuar në Zvicër. Ajo ua mundëson të gjithëve, grave dhe burrave, të rriturve dhe fëmijëve dhe të rinjëve që të pushojnë dhe të zbulojnë regjionet e ndryshme të vendit. Në kantonin e Fribourg-ut, ka shtigje të rezervuara posaçërisht për adhuruesit e ecjes këmbë.

Ecja në male

Frëngjisht: www.fribourgregion.ch > Activités

> Randonnées pédestres

Gjermanisht: www.fribourgregion.ch > D >

Aktivitäten > Wandern

www.wanderland.ch

Jeta shoqërore

Shoqatat janë të përbëra nga persona që zgjedhin të veprojnë së bashku dhe në mënyrë vullnetare për të:

- kultivuar interesat e përgjithshme: sportin, kulturën, kohën e lirë, etj.
- shprehur nevoja: prindër të nxënësve, migrantë, persona të moshuar, etj.
- ndërhyrë në jetën socio-ekonomike të vendit: sindikatat, shoqatat profesionale, grupe interesash, etj.

Zvicra është vendi i shoqërive dhe shoqatave. Janë me dhjetëra mijëra në tërë vendin e disa qindra në kantonin e Fribourg-ut. Shoqatat luajnë rol qëndror në jetën kantonale. Grupime sportive, shoqëri kulturore, shoqata që mbledhin pjesëtarë të komuniteteve të huaja, fusha e tyre e veprimit është shumë e gjërë. Të bërit anëtar i një shoqate mundëson integrimin në jetën lokale dhe hyrjen në kontakt me banorët e

Fribourg-ut. Shoqatat janë të hapura për të gjithë personat e interesuar. Për informata lidhur me shoqëritë lokale, konsultoni web-faqen e Internetit të komunës suaj ose drejtohuni te administrata e komunës suaj.

► **(53) Rrjeti vullnetar Netzwerk i kantonit të Fribourg-ut**

Jeta fetare

Kushtetuta e kantonit të Fribourg-ut garanton lirinë e ndërgjegjjes dhe besimit. Çdo person ka të drejtë të besojë ose jo dhe të praktikojë ose jo fenë e zgjedhur të tij. Këtu askush nuk mund të detyrohet. Liria fetare është edhe një e drejtë individuale që secili e ushtron lirisht në përputhje me bindjet e tij personale.

Autoritetet kantonale e pranojnë rolin e rëndësishëm të Kishave dhe të komuniteteve fetare në shoqëri. Krahas katolicizmit dhe protestantizmit, islami përbënë komunitetin e tretë fetar të kantonit. Ka afërsisht njëqind grupe të tjera fetare. Të gjitha këto komunitete ndajnë vullnetin e autoriteteve që të kultivojnë dialogun ndërfetar dhe të ruajnë paqen fetare.

Kisha katolike e kantonit të Fribourg-ut

www.cath-fr.ch

Kisha ungjillore e kantonit të Fribourg-ut

www.ref-fr.ch

Shoqata e Muslimanëve të Fribourg-ut

www.amfr.ch

Federata zvicerane e komuniteteve izraelite

www.swissjews.ch

17. Pjesëmarrja në jetën politike

Demokracia zvicerane ofron mundësi të shumta për t'u shprehur dhe për të marrë pjesë në çështjet politike.

Demokracia direkte

Zvicra është një nga demokracitë më të avancuara në botë. Të drejtat politike, të quajtura të drejta të popullit janë shumë të gjëra: e drejta për votim, e drejta për zgjedhje, e drejta për iniciativë, e drejta për referendum si dhe e drejta për propozim popullor në kantonin e Fribourg-ut. Populli mund gjithashtu të propozojë ndryshimin e kushtetutës (e drejta e iniciativës), ose të refuzojë një ligj të hartuar nga Parlamenti (e drejta për referendum). Në Zvicër, kur flitet për «sovrantin» bëhet fjalë për popullin.

Të drejtat politike ushtrohen në tri nivelet e Shtetit: Konfederata, kantonet, komunat. Populli zviceran është i ftuar të votojë shumë herë gjatë vitit: kantonet dhe komunat i organizojnë votimet në përgjithësi në të njëjten kohë me

Konfederatën. Këshilli federal (Conseil fédéral/Bundesrat), që përndryshe është qeveria zvicerane, është zgjedhur nga Parlamenti. Parlamenti, i zgjedhur nga populli, është i përbërë nga dy dhoma, Këshilli kombëtar (Conseil national/Nationalrat) dhe Këshilli i shteteve (Conseil des Etats/Ständerat).

Organet politike

Organet e zgjedhura mbajnë shpesh emrin «Conseil» (Këshill). Roli i tyre është që të mendojnë, të debatojnë dhe të bëjnë propozime që populli mund t'i pranojë ose t'i refuzojë.

Tri nivelet e pushtetit

Populli i Fribourg-ut është i ftuar afërsisht 4 herë në vit që të jap mendimin për çështjet:

Organi përfaqësues në nivelin e:		
	Parlamentit (Parlement / Parlament)	Qeverisë (Gouvernement / Regierung)
Komunat e Fribourg-ut	Asambleja komunale (Assemblée communale / Gemeindeversammlung) ose Këshilli i Përgjithshëm (Conseil général / Generalrat)	Këshilli Komunal (Conseil communal / Gemeinderat)
Kantoni i Fribourg-ut	Këshilli i Madh (Grand Conseil / Grosser Rat)	Këshilli i Shtetit (Conseil d'Etat / Staatsrat)
Konfederata Zvicerane	Këshilli Nacional (Conseil national / Nationalrat) dhe Këshilli i Shteteve (Conseil des Etats / Ständerat)	Këshilli Federal (Conseil fédéral / Bundesrat)

- Komunale (shembull: ndërtimi i një salle spektaklesh)
- Kantonale (shembull: ndërtimi i urës dhe tunelit Poya)
- Federale (shembull: ligji i ri për shtesat e fëmijëve)

Në çdo katër apo pesë vite, zgjedhen përfaqësuesit dhe përfaqësueset e parlamenteve dhe qeverive në nivelin komunal, kantonal dhe federal si dhe prefektët dhe prefektet në nivelin e distrikteve (rretheve).

Të drejtat politike të personave të huaj

Nëse nuk e keni shtetësinë zvicerane, banoni në kanton që 5 vite dhe keni lejeqëndrimin (permis C), i keni pikërisht të njëjtat të drejta politike në nivelin komunal sikur Zviceranët dhe Zviceranet. Nuk ka nevojë që të regjistrohemi në regjistrin e zgjedhjeve. Me përmbushjen e kushteve ligjore, do të merrni automatikisht materialin zyrtar në rast votimi ose zgjedhje. Kështu që mund të votoni për objektet komunale, të merrni pjesë në mbledhjet e asamblesë komunale, të zgjedhni anëtarët e këshillit të përgjithshëm (Conseil général) dhe të zgjedheni edhe ju vet.

Votuesit dhe votueset me shtetësi të huaj

Me numër afërsisht 16000, votuesit me shtetësi të huaj përfaqësojnë gati 10% të trupit elektoral të komunave të Fribourg-ut. Gati çdo i dyti person i rritur me shtetësi të huaj gëzon të drejtat politike komunale.

Format tjera të pjesëmarrjes në politikë

Përveç të drejtave politike, ekzistojnë mundësi tjera të shumta për pjesëmarrje në jetën politike dhe ndikim në të ardhmen e komunitetit. Një person mund, për shembull, të jetë aktiv në një shoqatë të lagjes, në një shoqëri lokale, organizatë profesionale, klub sportiv ose edhe në një komision këshillëdhënës. Sikur personat me shtetësi zvicerane, një person me shtetësi të huaj, i rritur ose i mitur, ka të drejtë për peticion. E drejta për peticion i jep secilit dhe secilës mundësinë t'i dërgojë autoriteteve kërkesa, propozime, kritika ose reklamime. Kjo mund të ushtrojë një lloj ndikimi në vendimet e marra nga organet e Shtetit.

► **(54) Partitë politike kryesore në kantonin e Fribourg-ut**

Natyrilizimi

Marrja e shtetësisë zvicerane është çështje e zgjedhjes dhe vullnetit personal. Në kanton natyralizohen çdo vit, afërsisht 1000 persona. Pasi të jetë marrë shtetësia, ajo jep të drejtën për votim dhe për t'u zgjedhur në nivelin komunal, kantonal dhe federal.

► (37) Shërbimi i gjendjes civile dhe i natyralizimeve

Kur t'a marrin shtetësinë zvicerane, personat e natyralizuar duhet të marrin pjesë në pritjen e organizuar nga autoritetet kantonale. Me këtë rast, qytetarët e rinj dhe qytetarët e reja duhet të bëjnë betimin solemn si në vijim: «Premtoj se do t'i jem besnik Kushtetutës federale dhe Kushtetutës kantonale; premtoj se do të ruaj dhe do të mbrojë në çdo rast, me përkushtim dhe besnikëri, të drejtat, liritë dhe pavarësinë e atdheut tim të ri, të cilit do t'i shërbejë me dinjitet».

18. Lista me adresa të nevojshme

▶ **(1) Zyra për integrimin e migrantëve-eve dhe parandalimin e racizmit**

Bureau de l'intégration des migrant-e-s et de la prévention du racisme IMR
Fachstelle für die Integration von MigrantInnen und für Rassismusrävention IMR
Grand-Rue 26, 1700 Fribourg
T: 026 305 14 85 – integration@fr.ch
www.fr.ch/integration

▶ **(2) Forumi për integrimin e migrantëve dhe migranteve – FIMM**

Forum pour l'intégration des migrantes et des migrants – FIMM
Forum für die Integration von MigrantInnen und Migranten – FIMM
Route de la Fonderie 7, Case postale 118, 1705 Fribourg
T: 076 589 79 43 – info@fimm-fribourg.ch
www.fimm-fribourg.ch

▶ **(3) Shërbimi për veprim social**

Service de l'action sociale – SASoc
Kantonales Sozialamt – KSA
Route des Cliniques 17, Case postale, 1701 Fribourg
T: 026 305 29 92 – sasoc@fr.ch
www.fr.ch/sasoc

▶ **(4) Shërbimi për popullatë dhe migrantë**

Service de la population et des migrants – Spomi
Kantonales Amt für Bevölkerung und Migration – BMA
Route d'Englisberg 11, 1763 Granges-Paccot
T: 026 305 14 92 – spomi@fr.ch
www.fr.ch/spomi

▶ **(5) Gazetat kryesore të Fribourg-ut**

• **La Gruyère**

Rue de la Léchère 10, Case postale 352, 1630 Bulle 1
T: 026 919 69 00 – redaction@lagruyere.ch
www.lagruyere.ch

• **La Liberté**

Boulevard de Pérolles 42, Case postale 960, 1701 Fribourg
T: 026 426 44 11 – redaction@laliberte.ch
www.laliberte.ch

• **Freiburger Nachrichten**

www.freiburger-nachrichten.ch
Rédaction Fribourg:
Bahnhofplatz 5, 1701 Fribourg
T: 026 347 30 02
Rédaction Morat:
Irisweg 12, 3280 Morat
T: 026 672 34 41

▶ **(6) Radiot regjionale**

• **Radio Fribourg / Freiburg**

Rue de Romont 35, Case postale 1312, 1701 Fribourg
T: 026 351 51 00 – radiofr@radiofr.ch
www.radiofr.ch
Radio Fribourg: FM 88.4 89.4 92.9 94.1 95.0 106.0 106.1
Radio Freiburg: FM 87.6 90.2 98.9 100.0 103.6 106.9

▶ **(7) Televizioni regjional**

• **La télé**

Boulevard de Pérolles 36
Case postale 205, 1705 Fribourg
T: 058 310 05 05 – info@latele.ch
Fribourg: T: 058 310 05 31
www.latele.ch

▶ **(8) Koordinimi kantonial kurse gjuhe për migrantë – COLAMIF**

Coordination cantonale cours de langue migrant-e-s – COLAMIF
Koordinationsstelle für Sprachkurse an MigrantInnen – COLAMIF
Croix-Rouge fribourgeoise
Rue G.-Techtermann 2, Case postale 279, 1701 Fribourg
T: 026 347 39 40
langues-sprachen@croix-rouge-fr.ch
Frëngjisht: www.croix-rouge-fr.ch > Service et Aides > Activités d'intégration > Coordination des cours de langues
Gjermanisht: www.croix-rouge-fr.ch > DE > Dienst und Hilfe > Integrationsveranstaltung > Koordination Sprachkurse

- ▶ **(9) a) Pjesa frankofone: Shërbimi i arsimimit të obligueshëm i gjuhës (frënge)**
Service de l'enseignement obligatoire de langue française – SEnOF
Rue de l'Hôpital 1, Case postale,
1701 Fribourg
T: 026 305 12 48 – senof@fr.ch
www.fr.ch/senof
- ▶ **b) Pjesa gjermanfone: Shërbimi i arsimimit të obligueshëm i gjuhës gjermane**
Amt für deutschsprachigen obligatorischen Unterricht – DOA
Spitalgasse 1, Postfach, 1701 Freiburg
T: 026 305 12 31 – doa@fr.ch
www.fr.ch/doa
- ▶ **(10) Shërbimi për përgatitje profesionale**
Service de la formation professionnelle – SFP
Amt für Berufsbildung – BBA
Derrière-les-Remparts 1, 1700 Fribourg
T: 026 305 25 00 – sfp@edufr.ch
www.fr.ch/sfp
- ▶ **(11) Shoqata Lexim dhe Shkrim – Dega në Fribourg**
Association Lire et Ecrire – Section de Fribourg
Verein Lesen und Schreiben – Sektion Freiburg
Rue St-Pierre 10, Case postale 915,
1701 Fribourg
T (frëngjisht): 026 422 32 62
T (gjermanisht): 079 488 21 76
fribourg@lire-et-ecrire.ch
www.lire-et-ecrire.ch
- ▶ **(12) Kryqi i kuq i Friburgut: Kursi «Jeta në Zvicër»**
Croix-Rouge fribourgeoise: Cours «Vie en Suisse»
Freiburgisches Rotes Kreuz: Kurs «Leben in der Schweiz»
Rue G.-Teuchtermann 2, Case postale 279,
1701 Fribourg
T: 026 347 39 40
langues-sprachen@croix-rouge-fr.ch
Frëngjisht: www.croix-rouge-fr.ch > Service et Aides > Activités d'intégration > Vie en Suisse
Gjermanisht: www.croix-rouge-fr.ch > DE > Dienst und Hilfe > Integrationsveranstaltung > Leben in der Schweiz
- ▶ **(13) Caritas Zvicër Dega e Friburgut, Shërbimi i interpretuesëve ndërkulturore «se comprendre»**
Caritas Suisse Département Fribourg,
Service d'interprétariat communautaire
«se comprendre»
Caritas Schweiz Abteilung Freiburg,
Interkultureller Übersetzungsdienst «se comprendre»
Rue de l'Industrie 21, Case postale 11,
1705 Fribourg
T: 0840 000 999 – secomprendre@caritas.ch
www.secomprendre.ch
- ▶ **(14) Biblioteka ndërkulturore LivrEchange**
Bibliothèque interculturelle LivrEchange
Interkulturelle Bibliothek LivrEchange
Avenue du Midi 3-7, 1700 Fribourg
T: 026 422 25 85 – info@livrechange.ch
www.livrechange.ch
- ▶ **(15) Shërbimi për strehim**
Service du logement – Slog
Wohnungsamt – WA
Boulevard de Pérolles 25, Case postale 1350,
1701 Fribourg
T: 026 305 24 13 – slog@fr.ch
www.fr.ch/slog
- ▶ **(16) Shoqata zvicerane e qiraxhinjëve – Dega në Fribourg**
Association suisse des locataires (ASLOCA) – Section fribourgeoise,
Secrétariat administratif,
Case postale 18, 1774 Cousset
T: 0848 818 800 – s'ka konsultime me e-mail
www.asloca.ch > Fribourg > shih web-faqen për konsultime pa termin në Bulle, Fribourg, Romont
- ▶ **(17) Shoqata e qiraxhinjëve gjermanofonë të Fribourg-ut**
Mieterinnen- und Mieterverband
Deutschfreiburg
Case postale 41, 3185 Schmitten
T: 026 496 46 88
mieterverband.deutschfreiburg@gmx.ch
www.mieterverband.ch

▶ **(18) Zyra për qarkullim dhe lundrim e kantonit të Fribourg-ut**

Office de la circulation et de la navigation
du canton de Fribourg – OCN
Amt für Strassenverkehr und Schifffahrt
des Kantons Freiburg – ASS
Route de Tavel 10, Case postale 192,
1707 Fribourg
T: 026 484 55 55 – info@ocn.ch
www.ocn.ch

▶ **(19) Arka për kompensim e kantonit të Fribourg-ut**

Caisse de compensation du canton
de Fribourg – CCCFR
Ausgleichskasse des Kantons Freiburg – AKFR
Impasse de la Colline 1, Case postale 176,
1762 Givisiez
T: 026 305 52 52 – ecasfr@fr.ch
www.caisseavsf.fr.ch

▶ **(20) Shërbimi publik për punësim**

Service public de l'emploi – SPE
Amt für den Arbeitsmarkt – AMA
Boulevard de Pérolles 25, Case postale 1350,
1701 Fribourg
T: 026 305 96 00 – spe@fr.ch
www.fr.ch/spe

▶ **(21) Shërbimi kantonal për kontribute**

Service cantonal des contributions – SCC
Kantonale Steuerverwaltung – KSTV
Rue Joseph-Piller 13, Case postale,
1701 Fribourg
T: 026 305 11 11 – scc@fr.ch
www.fr.ch/scc

▶ **(22) Bashkimi sindikal i Fribourg-ut**

Union Syndicale Fribourgeoise – USF
Freiburger Gewerkschaftsbund – FGB
Rue des Alpes 11, Case postale 1541,
1701 Fribourg
T: 026 322 74 45 – usfr@bluewin.ch
www.uss.ch

▶ **(23) Zyra për barazi burra-gra dhe familje**

Bureau de l'égalité hommes-femmes
et de la famille – BEF
Büro für die Gleichstellung von Frau
und Mann und für Familienfragen – GFB
Rue de la Poste 1, 1701 Fribourg
T: 026 305 23 86 – bef@fr.ch
Frëngjisht: www.fr.ch/bef
Gjermanisht: www.fr.ch/gfb
www.familles-fribourg.ch

▶ **(24) Qendra e kontaktit zviceranë- të imigruar/SOS Racizmi – CCSI**

Centre de contact suisse-sse-s-immigré-e-s/
SOS Racisme – CCSI
Kontaktstelle SchweizerInnen-
AusländerInnen/SOS Rassismus – CCSI
Rue des Alpes 11, CP 366, 1701 Fribourg
T: 026 424 21 25 – info@ccsi-fr.ch
www.ccsi-fr.ch

▶ **(25) Shoqata Chèque Emploi – Qendra për integrim socioprofesional**

Association Chèque Emploi – Centre
d'intégration socioprofessionnelle
Verein Service Check – Institution
für sozio-professionnelle Integration
Route des Daillettes 1, Case postale 31,
1709 Fribourg
T: 026 426 02 40 – cheque-emploi@cisf.ch
www.cheque-emploi-fribourg.ch

▶ **(26) Fri-Santé – Zonë trajtimi**

Fri-Santé – Espace de soins
Fri-Santé – Raum für Behandlung
Boulevard de Pérolles 30, 1700 Fribourg
T: 026 341 03 30 – info@frisante.ch
www.frisante.ch

▶ **(27) Griséliidis Fribourg**

Boulevard de Pérolles 30, 1700 Fribourg
T: 026 321 49 45 – griseliidis@frisante.ch
www.griseliidis.ch

▶ **(28) Shërbimi dentar shkollor**

Service dentaire scolaire – SDS
Schulzahnpflegedienst – SZPD
Boulevard de Pérolles 23, 1700 Fribourg
T: 026 305 98 00 – sds@fr.ch
www.fr.ch/sds

- ▶ **(29) Shoqata e Fribourg-ut e institucioneve për persona të moshuar – AFIPA**
Association fribourgeoise des institutions pour personnes âgées – AFIPA
Vereinigung Freiburgerischer Alterseinrichtungen – VFA
Route Saint-Nicolas-de-Flüe 2, 1700 Fribourg
T: 026 915 03 43 – office@afipa-vfa.ch
www.afipa-vfa.ch
- ▶ **(30) Shoqata e Fribourg-ut për ndihmë dhe trajtim në shtëpi**
Association fribourgeoise aide et soins à domicile – AFAS
Spitex Verband Freiburg – SVF
Secrétariat cantonal
Route Saint-Nicolas-de-Flüe 2, 1700 Fribourg
T: 026 321 56 81 – info@aide-soins-fribourg.ch
www.aide-soins-fribourg.ch
- ▶ **(31) Pro Senectute Fribourg**
Chemin de la Redoute 9, Case postale 44, 1752 Villars-sur-Glâne 1
T: 026 347 12 40 – info@fr.pro-senectute.ch
www.fr.pro-senectute.ch
- ▶ **(32) Zyra për sigurim invalidor e kantonit të Fribourg-ut**
Office de l'Assurance-Invalidité du canton de Fribourg – Office AI
Invalidenversicherungsstelle des Kantons Freiburg – IV-Stelle
Rte du Mont-Carmel 5, 1762 Givisiez
T: 026 305 52 37 – info@aifr.ch
www.aifr.ch
- ▶ **(33) Pro Infirmis – Service fribourgeois**
Pro Infirmis – Service fribourgeois
Pro Infirmis – Beratungsstelle Freiburg
Route Saint-Nicolas-de-Flüe 2, Case postale 98, 1705 Fribourg
T: 026 347 40 00 – fribourg@proinfirmis.ch
www.proinfirmis.ch
- ▶ **(34) Shërbimi edukativ lëvizës**
Service éducatif itinérant – SEI
Frühberatungsdienst – FBD
Fondation Les Buissonnets,
Rte de Villars-les-Joncs 3,
Case postale 155, 1707 Fribourg
T: 026 484 21 13 – sei@lesbuissonnets.ch
www.lesbuissonnets.ch
- ▶ **(35) Sektori planifikimi familjar dhe informata seksuale**
Secteur planning familial et information sexuelle
Abteilung Familienplanung und Sexualinformation
Rue de la Grand-Fontaine, 1700 Fribourg
T: 026 305 29 55 – planningfamilial@fr.ch
www.fr.ch/spfis
- ▶ **(36) Qendra për përkrahje dhe parandalim në fushën e VIH/Sida dhe IST**
Empreinte: Centre de soutien et de prévention dans le domaine du VIH/Sida et IST
Boulevard de Pérolles 57, 1700 Fribourg
T: 026 424 24 84 – empreinte@tremplin.ch
www.sida-fr.ch
- ▶ **(37) Shërbimi i gjendjes civile dhe i natyralizimeve**
Service de l'état civil et des naturalisations – SECiN
Amt für Zivilstandswesen und Einbürgerungen – ZEA
Boulevard de Pérolles 2, Case postale 471, 1701 Fribourg
T: 026 305 14 17 – etatcivil@fr.ch
www.fr.ch/secin
- ▶ **(38) Sarigai - Shoqata e Friburgut për personat lesbike, gays, bi dhe trans* (LGBT*)**
Sarigai – Association fribourgeoise pour des personnes lesbiennes, gays, bi et trans* (LGBT*)
Sarigai – Freiburger Organisation für lesbische, schwule, bisexuelle und Trans* Menschen (LGBT*)
Case postale 282, 1709 Fribourg
T: 079 610 59 37 – sarigai@sarigai.ch
www.sarigai.ch

- ▶ **(39) Shoqata Solidarité Femmes – Qendra LAVI për gra viktimë të dhunës dhe akteve kriminale**
Association Solidarité Femmes – Centre LAVI pour femmes victimes de violence et d'infraction pénale
Verein Frauenhaus – Opferberatungsstelle für Frauen als Opfer von Gewalt und Straftaten
Case postale 1400, 1701 Fribourg
T: 026 322 22 02 (përgjigjet 24h/24h)
info@sf-lavi.ch
www.sf-lavi.ch
- ▶ **(40) Qendra për konsultime LAVI për fëmijë, burra dhe viktimë të trafikut**
Centre de consultation LAVI pour enfants, hommes et victimes de la circulation
Opferberatungsstelle für Kinder, Männer und Opfer von Verkehrsunfällen
Rue Hans-Fries 1, Case postale 29, 1705 Fribourg
T: 026 305 15 80 – LAVI-OHG@fr.ch
Frëngjisht: www.fr.ch/sej/lavi
Gjermanisht: www.fr.ch/ja/ohg
- ▶ **(41) Shoqata Zyra familjare Fribourg**
Association Office familial Fribourg
Verein Paar- und Familienberatung Freiburg
Rue de Romont 29-31, Case postal 1131, 1701 Fribourg
T: 026 322 10 14 – info@officefamilial.ch
www.officefamilial.ch
- ▶ **(42) Shërbimi për fëmijë dhe të rinjë**
Service de l'enfance et de la jeunesse – SEJ
Jugendamt – JA
Boulevard de Pérolles 24, Case postale 29, 1705 Fribourg
T: 026 305 15 30 – sej-ja@fr.ch
www.fr.ch/sej
- ▶ **(43) Shoqata espacefemmes**
Association espacefemmes
Verein frauenraum
Rue Hans-Fries 2, 1700 Fribourg
T: 026 424 59 24 – info@espacefemmes.org
Frëngjisht: www.espacefemmes.org
Gjermanisht: www.frauenraum.org
- ▶ **(44) Frabina – Këshillimore për gra dhe çifte binacionale**
Frabina – Agence de consultation pour femmes et couples binationaux
Frabina – Beratungsstelle für Frauen und binationale Paare
Laupenstrasse 2, 3008 Berne
T: 031 381 27 01 – info@frabina.ch
www.frabina.ch
- ▶ **(45) Shoqata EX-pression Fribourg**
Association EX-pression Fribourg
Verein EX-pression Freiburg
Route de la Vignettaz 48, 1700 Fribourg
T: 0848 08 08 08 – info@ex-pression.ch
www.ex-pression.ch
- ▶ **(46) Edukata familjare**
Education familiale
Familienbegleitung
Case postale 2, 1707 Fribourg
T (frëngjisht): 026 321 48 70
T (gjermanisht): 026 322 86 33
contact@educationfamiliale.ch
www.educationfamiliale.ch
- ▶ **(47) Federata e Fribourg-ut për përkujdesje familjare ditore**
Fédération Fribourgeoise d'Accueil Familial de Jour
Verein Freiburgischer Tagesfamilien
Rue de Romont 2, 1700 Fribourg
federation@accueildejour.ch
www.accueildejour.ch > Shih web-faqen për ti mësuar numrat e telefonit për regjione
- ▶ **(48) Federata e Fribourg-ut për çerdhe dhe kopshte fëmijësh**
Fédération des crèches et garderies fribourgeoises
Freiburger Krippenverband
Rte de la Fonderie 8C, Case postale 167, 1707 Fribourg
T: 026 429 09 92 – info@crechesfribourg.ch
www.crechesfribourg.ch

► **(49) Shërbimi për orientim profesional dhe përgatitje të të rriturve**

Service de l'orientation professionnelle et de la formation des adultes – SOPFA
 Amt für Berufsberatung und Erwachsenenbildung – BEA
 Rue St-Pierre Canisius 12, 1700 Fribourg
 T: 026 305 41 86 – sopfa@fr.ch
www.fr.ch/sopfa

► **(50) a) Pjesa frankofone: Koordinatorja për shkollimin e fëmijëve të migrantëve dhe kurseve të gjuhës dhe kulturës së vendit të originës**

Coordinatrice pour la scolarisation des enfants de migrants et les cours de langue et culture d'origine
 Chemin des Mazots 2, 1700 Fribourg
 T: 026 305 12 48 – senof@fr.ch
www.fr.ch/senof

b) Pjesa gjermanofone: Koordinatorja për shkollimin e fëmijëve të migrantëve dhe kurseve të gjuhës dhe kulturës së vendit të originës

Koordinatorin für die Schulung fremdsprachiger Kinder (KG-PS-OS) und die Kurse in Heimatlicher Sprache und Kultur (HSK)
 Schulinspektorat KG-PS Deutschfreiburg
 Mariahilfstrasse 2, 1712 Tafers
 T: 026 305 40 89 – doa@fr.ch
www.fr.ch/doa

► **(51) Shërbimi i subvencioneve për shkollim**

Service des subsides de formation – SSF
 Amt für Ausbildungsbeiträge – ABBA
 Route-Neuve 7, Case postale, 1701 Fribourg
 T: 026 305 12 51 – bourses@fr.ch
www.fr.ch/ssf

► **(52) Shërbimi për ambient**

Service de l'environnement – SE
 Amt für Umwelt – AfU
 Route de la Fonderie 2, Case postale,
 1701 Fribourg
 T: 026 305 37 60 – sen@fr.ch
www.fr.ch/sen

► **(53) Rrjeti vullnetar Network i kantonit të Fribourg-ut**

RéseauBénévolatNetzwerk
 Fribourg Freiburg – RBN
 Route de la Fonderie 8c, 1700 Fribourg
 T: 026 422 37 07 – info@benevolat-fr.ch
www.benevolat-fr.ch

► **(54) Partitë politike kryesore në kantonin e Fribourg-ut**

- **Parti démocrate-chrétien – PDC**
 Christlichdemokratische Volkspartei – CVP
www.cvp-fr.ch
- **Parti socialiste – PS**
 Sozialdemokratische Partei – SP
www.ps-fr.ch
- **Parti libéral-radical – PLR**
 FDP.Die Liberalen – FDP
www.plrf.ch
- **Parti de l'Union Démocratique du Centre – UDC**
 Schweizerische Volkspartei – SVP
www.udc-fr.ch
- **Parti chrétien social – PCS**
 Christlichsoziale Partei – CSP
www.csp-pcs.ch
- **Les Verts**
 Die Grünen
www.verts-fr.ch
- **Parti vert-libéral – PVL**
 Grünliberale Partei
fr.vertsliberaux.ch



Urgjencat për tërë Zvicrën

Policia	117
Zjarrëfshësit (zjarri, uji, gaz)	118
Ambulanca	144
Dora e zgjatur (shqetësime psikjke)	143
Informacione toksikologjike (helmimi, helmi)	145

Nëse jeni në situatë urgjence

- Ruajeni qetësinë
- Identifikoni rreziqet
- Strehohuni (largohuni nga rreziku)
- Kërkoni ndihmë
- Ofroni ndihmë

Zyra për integrimin e migrantëve dhe parandalimin e racizmit

Grand-Rue 26
1700 Fribourg
T: 026 305 14 85
integration@fr.ch

www.fr.ch/integration